



TË
EKSPLOROJMË...

...DHE LUAJMË
SË BASHKU!

Dizajni ndërkulturor

MODELE TË AKTIVITETEVE NDËRKULTURORE

HAPAT DREJT NDËRKULTURALIZMIT

SI TË ARRIHET ARSIMIMI NDËRKULTUROR

Ndërkulturalizmi në arsim



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
Ministarstvo Obrazovanja, Nauke, Tehnologije i Inovacija
Ministry of Education, Science, Technology and Innovation*



Qendra për Dialog Nansen Shkup
Nansen Dijalog Centar Skopje
Nansen Dialogue Centre Skopje

Ndërkulturalizmi në arsim

- Doracak për mësimdhënës -

Prill, 2023

Përmbajtja

Hyrje	4
Përkufizimi i koncepteve themelore	8
Parimet, qëllimet dhe detyrat e edukimit ndërkulturor	9
Dimensioni ndërkulturor i përmbajtjeve edukative dhe arsimore	12
Dizajni dhe mjedisi pedagogjik ndërkulturor	16
Kompetencat ndërkulturore	18
Modele të edukimit ndërkulturor dhe veprimtarive arsimore	20
--- Matja dhe zgjidhja e problemit	21
--- Familja ime e ngushtë	30
--- Të dëgjojmë muzikë	34
--- Përralla	38
--- Drita	47
--- Forca dhe lëvizja	51
--- Ritmi	54
--- Evropa pas Revolucionit Francez	61
--- Koha	72
--- Lidhja jonike	78
--- Mësimi i gjuhës të njëri-tjetrit	88
--- Diversiteti kulturor dhe fetar në Kosovë	92
--- Kuptimi dhe tejkalimi i paragjytimeve	97
--- Festimet dhe festat (festat fetare dhe laike)	104
--- Stereotipet	116
--- Ushqimet dhe gatimet tradicionale	120

Ky doracak është rezultat i bashkëpunimit të ngushtë dhe sinergjisë ndërmjet Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, mësuesve nga komunitete dhe lokalitete të ndryshme dhe konsulentëve nga Qendra e Dialogut Nansen në Shkup.

Botimi i këtij doracaku është mundësuar me përkrahjen e Misionit të OSBE-së në Kosovë. Përmbajtja këtu nuk pasqyron domosdoshmërisht qëndrimin zyrtar të Misionit të OSBE-së në Kosovë.

Kontribuesit:

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit: Feime Llapashtica
Lipscomb, Shqipe Gashi Ramadani, Arbër Salihu

Qendra për dialog Nansen Shkup: Sonaj Bilal, Osman Emin, Biljana Krsteska Papić

Mësimdhënësit: Faruk Avdiu, Anesa Čolaković, Sevdija Kandić Ćeman, Arbresha Haziri,
Mersin Kazazi, Shemi Kodroli, Urma Menekshe, Sunčica Milenković, Blerta Muji,
Milovan Stajić

Dizajni: Vane Rujkov

Hyrje

ARSIMIMI NDËRKULTUROR ËSHTË NJË TREND ARSIMOR BASHKËKOHOR, POR EDHE PËRGJIGJE KONSTRUKTIVE GLOBALE NDAJ PROCESIVE INTENSIVE TË MIGRIMIT DHE DIVERSITETIT TË KOMUNITETEVE SHOQËRORE QË PASQYROJNË HETEROGJENITETIN KULTUROR, GJUHËSOR DHE ETNIK.



Kosova, si shoqëri shumëetnike dhe shumëkulturore, po përballet me sfidën por edhe me aspiratën e ndërtimit të nismave afatgjata të qëndrueshme dhe konstruktive për promovimin e arsimit ndërkulturor. Kjo qasje dhe strategji edukative duhet të jetë hallkë e rëndësishme për komunikimin dhe njohjen e ndërsjellë ndërmjet komuniteteve të ndryshme. Kjo është arsyeja pse arsimimi ndërkulturor duhet të shihet si nevojë, por edhe të njihet si mundësi për të gjetur raportin optimal mes diversitetit kulturor dhe kohezionit social.

Ndërkulturalizmi në arsim duhet të jetë vlerë dhe mjeti që do t'i përgjigjet sfidës së të mësuarit për të jetuar së bashku duke promovuar në mënyrë aktive praktika arsimore gjithëpërfshirëse, duke nxitur qytetarinë demokratike dhe të drejtat e njeriut në jetën publike, profesionale dhe private. Ndërkulturalizmi në arsim përfshin menaxhimin konstruktiv të dallimeve, vetëvlerësimin, komunikimin efikas, respektimin e të tjerëve, mirëkuptimin ndërkulturor, etj. (Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, 2016).

Drejtimi ynë themelor gjatë hartimit të këtij doracak do të jetë që të përcaktojmë një gamë të gjerë të synimeve globale, të cilat janë gjithashtu të lidhura ngushtë me dimensionin ndërkulturor të arsimit parauniversitar në Kosovë, që synojnë:

- ngritjen dhe zhvillimin e identitetit personal dhe ndjenjës së përkatësisë ndaj Kosovës dhe përkatësisë kulturore të saj;
- promovimin e vlerave kulturore dhe qytetare;
- zhvillimin e përgjegjësisë ndaj vetes, ndaj të tjerëve, ndaj komunitetit shoqëror dhe mjedisit;
- trajnimin për të jetuar dhe punuar në kontekste të ndryshme sociale dhe kulturore (Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, 2016)

Një shtyllë e rëndësishme për krijimin e rekomandimeve dhe zgjidhjeve ndërkulturore do të jetë gjithashtu përkufizimi i një grupi të kompetencave kryesore, të cilat do të përcaktojnë raportin e vlerave dhe elementeve ndërkulturore me gjashtë fushat e veçanta të kompetencave:

- Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit
- Kompetenca e të menduarit
- Kompetenca e të mësuarit
- Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis
- Kompetenca personale
- Kompetenca qytetare (Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, 2016)

Korniza e arsimit ndërkulturor do të hartohet me përkufizime që ofrojnë perspektivë të re për angazhimin ndërkulturor në arsimin parauniversitar në Kosovë. Është arsimim për komunitetin, solidaritetin, respektin, tolerancën reciproke, ndihmën, besimin dhe vlerat e tjera universale njerëzore (Koncepti për Arsimin Ndërkulturor, 2016).

“Arsimimi ndërkulturor duhet të organizohet në mënyrë që të realizohet detyra e shumanshme, pra arsimimi për ndjeshmëri, solidaritet, respekt ndërkulturor, si dhe mënyra jonacionaliste e të menduarit” (Essinger, 1987 sipas Sablić, 2014).

Sipas gamës së aftësive, qëndrimeve dhe vlerave ndërkulturore, është e nevojshme të theksohen katër postulatet që do të shërbejnë si udhërrëfyesi ynë në formësimin e përmbajtjes së këtij botimi:

1. Arsimimi ndërkulturor është i nevojshëm për të gjithë fëmijët dhe nxënësit, pavarësisht moshës.

2. Arsimimi ndërkulturor duhet të jetë komponentë e rrënjësor natyreshëm në procesin e edukimit dhe arsimimit të përditshëm, pavarësisht nga struktura etnike apo gjuhësore e nxënësve dhe mësuesve në një shkollë.

2. Arsimimi ndërkulturor nuk merret vetëm me dallimet etnike, racore dhe gjuhësore, por duhet të ndikojë edhe në ngritjen e ndërgjegjësimit të nxënësve për dallimet në shumë fusha të jetës së përditshme. (p.sh. statusi social, gjinia, mosha, profesioni, prejardhja familjare, stili i të mësuarit, ushqimi, pamja fizike, etj.)

3. Arsimimi ndërkulturor nuk nënkupton medoemos futjen e një lënde të veçantë, por duhet të jetë pasqyrimi i një qasjeje ndërkurrikulare, ashtu siç duhet të jetë pjesë si e kurrikulës formale ashtu edhe asaj të “fshehur”. (NDC Shkup, Hapat ndërkulturorë, 2022)

Vlerat mbi të cilat bazohet koncepti i arsimimit ndërkulturor janë përfshirë në një sërë dokumentesh ndërkombëtare që nga mesi i shekullit të kaluar, si dhe në një sërë deklaratash, raportesh dhe rekomandimesh që ofrojnë udhëzime për zhvillimin e arsimit në Evropë dhe përtej saj.

Rekomandimet e Zyrës së Komisionarit të Lartë të OSBE-së për Pakicat Kombëtare theksojnë rolin dhe rëndësinë e arsimit në promovimin

e idesë së të drejtave dhe mundësive të barabarta për secilin subjekt edukativ dhe arsimor të përfshirë, dhe forcimin e besimit ndërmjet komuniteteve të ndryshme. “Rekomandimet e Hagës në lidhje me të drejtat arsimore të pakicave kombëtare” dhe shpjegimet janë krijuar si kornizë e gjerë që duhet të shërbejë si pikënisje për zhvillimin e politikave arsimore formale të qeverisë. Këto politika duhet t’u përshtaten mundësive në nivelin lokal dhe rajonal, në mënyrë që të sigurohet pjesëmarrje e barabartë e individëve nga bashkësitë e ndryshme etnike në të gjitha aspektet e edukimit dhe arsimimit të tyre. “Udhëzimet e Lubjanës për integrimin e shoqërive të shumëllojshme” ofrojnë gjithashtu rekomandime për krijimin e politikave të integruara arsimore si bazë për arritjen e integritimit në shoqëri dhe për nxitjen e njohurive, ndërveprimit dhe mirëkuptimit ndërmjet studentëve nga komunitete të ndryshme. Udhëzimet theksojnë nevojën që shtetet të zhvillojnë një sistem të integruar arsimor të dizajnuar për të ofruar qasje dhe mundësi të barabarta për arritjen e rezultateve arsimore për të gjithë studentët, pavarësisht nga përkatësia e tyre (Koncepti për arsimin ndërkulturor, 2016).

Prandaj universaliteti i nevojës globale për këto produkte që do të ofrojnë një prezantim të strukturuar të qasjeve dhe praktikave të mundshme të edukimit ndërkulturor dhe arsimor.

Shpresojmë sinqerisht që ky doracak do të frymëzojë dhe ndihmojë punëtorët e arsimit në hartimin dhe zbatimin e nismave të ndryshme ndërkulturore, si një hap drejt transformimit dhe pasurimit të mjedisit shkollor me dimension ndërkulturor.

Autorët



Përkufizimi i koncepteve bazë

Për shkak të identifikimit të shpeshtë, është e nevojshme të bëhet dallimi i qartë mes koncepteve të shoqërisë/arsimit shumëkulturore dhe ndërkulturore.

Multikulturalizmi dhe ndërkulturalizmi i referohen dy llojeve të koncepteve shoqërore, të cilat ndryshojnë nga njëri-tjetri në shtrirjen e ndërveprimit mes grupeve të ndryshme shoqërore brenda një shoqërie.

Multikulturalizmi i referohet ekzistencës së disa kulturave të ndryshme në një zonë të vetme gjeografike, të cilat nuk janë në një kontakt dhe ndërveprim të natyrshëm të detyrueshëm, të përditshëm dhe të përhershëm. Ky parim nënkupton njohjen, ekzistencën dhe respektimin e diversitetit, por nuk nënkupton domosdoshmërisht lidhjen dhe ndikimin e ndërsjellë të dallimeve (racore, etnike, gjuhësore, fetare, gjinore, sociale, etj.). Multikulturalizmi është një lloj konfirmimi se kulturat e shumta bashkëjetojnë brenda një konteksti të përbashkët gjeografik. Komunitetet shoqërore heterogjene që arrijnë të ruajnë cilësi të tilla si toleranca dhe respekti janë pasqyrim i drejtpërdrejtë i karakterit të multikulturalizmit.

Ndërkulturalizmi, nga ana tjetër, nënkupton marrëdhënie të hapura ndërveprimi dhe lidhje ndërmjet grupeve të ndryshme kulturore, kombëtare e të tjera që besojnë dhe promovojnë vlera të tilla si toleranca, respekti reciprok, barazia dhe komunikimi i hapur. (NDC Shkup, Si të arrihet arsimimi ndërkulturore)

Ndërkulturalizmi bazohet në dy parakushte kryesore:

- shkëmbim, dhe
- ndërveprim ndërmjet komuniteteve, grupeve apo kulturave të ndryshme.

Arsimimi ndërkulturore është një sistem edukimi dhe qasjesh edukative të ndryshme sistematike, të planifikuara, afatgjata dhe delikate që synojnë të promovojnë të gjitha llojet e diversitetit dhe tjetërsisë. Diversiteti kulturor, gjuhësor, gjinor, social, etnik dhe fetar do të ndikojë pozitivisht në sensibilizimin e të gjitha subjekteve edukative dhe arsimore për njohje, respektim dhe jetë në një mjedis që është burim i shumë dallimeve. (Koncepti për Arsim Ndërkulturore, 2016).

Kur kuptohet nga prizmi i të gjithë elementëve të lartpërmendur, arsimimi ndërkulturore duhet të jetë njëkohësisht edhe platformë mbështetjeje për:

- arsimin gjithëpërfshirës
- edukimin qytetar
- edukimin për paqen
- edukimin për ekologjinë
- edukimin për barazinë gjinore

Parimet, qëllimet dhe detyrat e arsimit ndërkulturore

Tendenca dhe aspirata e arsimit ndërkulturore si koncept është të ofrojë mundësi të barabarta që çdo nxënës të arrijë potencialin e vet të plotë. Njëkohësisht, kjo qasje edukative dhe arsimore u mundëson brezave të rinj të nxënësve që të përgatiten për të marrë pjesë aktive në zhvillimin e shoqërisë ndërkulturore.

Edukimi ndërkulturore nuk kufizohet vetëm në përvetësimin e njohurive për tjetrin, por ai gjithashtu u mundëson nxënësve të zhvillojnë, ruajnë dhe përmirësojnë shkathtësitë jetësore që kërkohen për ndërveprime efektive brenda një shoqërie të larmishme.

Arsimimi ndërkulturore sensibilizon të gjitha subjektet në procesin edukativo-arsimor për njohjen, respektimin dhe jetesën në një mjedis të larmishëm të përbërë nga individë apo grupe që janë eksponentë të tjetërsisë.

Vlerat e mëposhtme janë të rrenjosura në karakterin e arsimit ndërkulturore:



Karakteri i ndërkulturalizmit sjell një frymë të re në fushën e arsimit dhe edukimit: arsimin për kompetencë, konkurrencë dhe komunikim lokal, rajonal, evropian, por edhe ndërkombëtar.

Platforma e arsimit ndërkulturor përfaqësohet nga **parimet globale** si në vijim:

- respektimi i identitetit kulturor të fëmijëve dhe nxënësve duke ofruar arsim cilësor për të gjithë;
- përvetësimi i njohurive dhe formimin e qëndrimeve dhe aftësive që janë të nevojshme për pjesëmarrje aktive në jetën shoqërore;
- përvetësimi i njohurive dhe formimi i qëndrimeve dhe aftësive që mundësojnë zhvillimin e respektit, mirëkuptimit dhe solidaritetit ndërmjet individëve, grupeve dhe kombeve etnike, sociale, kulturore dhe fetare. *(Udhëzimet e UNESCO-s për arsimin ndërkulturor, 2006).*

Këto parime shërbejnë si udhëzime për planifikimin e qasjeve të ndryshme për zbatimin e nismave të arsimit ndërkulturor dhe arsimor në mjediset shkollore.

Qëllimi i arsimit ndërkulturor është përmirësimi i praktikave edukative dhe arsimore përmes transformimit personal dhe institucional si bazë për një ndryshim më të gjerë shoqëror në të ardhmen.

Qëllimet globale të arsimit ndërkulturor janë:

- ndërtimi i politikave dhe strategjive arsimore për mundësi të barabarta për të gjithë;
- garantimi i të drejtave të çdo individi në kontekstin e diversitetit kulturor;
- promovimi i besimit reciprok, respektit, barazisë dhe mosdiskriminimit në komunitetet dhe mjediset shumëkulturore;
- mundësimi i pjesëmarrjes sociale të çdo individi në komunitetin ndërkulturor;
- nxitja e dialogut ndërmjet subjekteve edukative dhe arsimore me përkatësi të ndryshme etnike, gjinore, sociale, kulturore, fetare dhe gjuhësore;
- arritja e kohezionit social dhe të bashkëjetesës paqësore.

Operacionalizimi dhe zbatimi i menjëhershëm i qëllimeve globale të arsimit ndërkulturor bazohen në **detyrat** në vijim:

- ndërmarrjen e nismave integruese dhe ndërkulturore në përputhje me nevojat reale të shkollave shumëkulturore;
- zhvillimin e mekanizmave dhe praktikave për veprim të paanshëm dhe jodiskriminues në të gjitha segmentet e procesit edukativo-arsimor;
- sigurimin e kushteve për arritjen e diversitetit gjuhësor dhe kulturor në institucionet arsimore;
- Zhvillimin e aftësive për komunikim dhe bashkëpunim të hapur, të drejtpërdrejtë dhe konstruktiv të subjekteve edukative dhe arsimore;
- Trajnimin e të gjithë pjesëmarrësve në procesin edukativo-arsimor për zgjidhjen paqësore dhe transformimin e situatave të konfliktit;
- sensibilizimin e subjekteve edukative dhe arsimore për njohjen e burimeve të paragjytimeve dhe stereotipeve dhe hartimin e strategjive për tejkalimin e suksesshëm të tyre;
- zhvillimin e ndjeshmërisë për tjetrin, si shembull i veçorive të ndryshme kulturore, sociale, gjuhësore dhe fetare;
- nxitjen dhe zhvillimin e të menduarit kritik në praktikën edukative-arsimore si faktor për arritjen e një mjedisi demokratik dhe të drejtë social;
- krijimin e një mjedisi shkollor të sigurt ndërkulturor dhe gjithëpërfshirës;
- vënien e formave të ndryshme të bashkëpunimit ndërkulturor ndërmjet institucioneve edukative-arsimore dhe komunitetit lokal

(Koncepti për arsimin ndërkulturor, 2016)

Qëllimet dhe detyrat e paraqitura sugjerojnë gjithëpërfshirjen e platformës që duhet të shërbejë si bazë për zhvillimin dhe ndërtimin e nismave dhe qasjeve të ndryshme edukative-arsimore, duke filluar nga niveli parashkollor e deri në arsimin e lartë, si elementë të arsimit ndërkulturor.

Duhet theksuar se arsimimi ndërkulturor duhet të bëjë një ndikim gjithëpërfshirës pozitiv dhe transformim të aspekteve të shumta të punës edukative dhe arsimore, duke përfshirë:

- përmbajtjen edukative,
- format, metodat dhe teknikat e të nxënësve dhe të mësimdhënies,
- tekstet shkollore, materialet dhe burimet tjera,
- aktivitetet jashtëkurrikulare,
- kompetencat e akterëve edukativë dhe arsimorë,
- mjedisin në institucionet edukative dhe arsimore,
- lidhjen e institucioneve edukative-arsimore me komunitetin e gjerë.

Të gjitha aspektet që mund të ndikohen pozitivisht nga profesionistët e edukimit dhe arsimi do të bëhen të qarta në kapitullin vijues.

Dimensioni ndërkulturor i përmbajtjes edukative dhe arsimore

A) Arsimimi ndërkulturor në procesin e obligueshëm edukativo-arsimor

Arsimimi ndërkulturor duhet të jetë pjesë e rregullt e procesit arsimor, përmes inkuorporimit stimuluës, sistematik dhe të planifikuar të elementeve ndërkulturore në përmbajtje të ndryshme mësimore të obligueshme të përcaktuara në kurrikulë.

ARSIMIMI NDËRKULTUROR NUK DUHET TË ORGANIZOHET SI LËNDË MËSIMORE (SHITESË) E RE, AS NUK DUHET TË REDUKTOHET NË PËRMBAJTJE TË NJË LËNDE TË VETME.

Arsimimi ndërkulturor duhet të jetë pjesë e të gjitha cikleve arsimore. Edukimi dhe komponentët e përmbajtjes duhet të përshtaten në mënyrë të duhur për nevojat e grup moshave të ndryshme të nxënësve.

Edukimi ndërkulturor nuk duhet të reduktohet në një ose disa fusha, fusha apo ngjarje tematike.

Aktivitetet ndërkulturore duhet të zhvillohen në të gjitha lëndët dhe fushat (p.sh., duke përdorur burime të ndryshme didaktike, duke iniciuar situata problemore që do të inkurajonin dhe nxisin të nxënës bashkëpunues, kontaktin me kulturat e tjera dhe arritjet e tyre shkencore).

Në të vërtetë, arsimi ndërkulturor është pjesë e të gjitha lëndëve dhe fushave të detyrueshme. Ky doracak ofron shembuj konkretë se si të zbatohet ndërkulturalizmi në arsim përmes lëndëve të ndryshme mësimore.

Profesionistët edukativë dhe arsimorë shpesh sugjerojnë se zbatimi i aktiviteteve ndërkulturore do të merrte shumë kohë në mësim të rregullt, në dëm të përmbajtjeve mësimore të obligueshme. Përkundrazi, elementet ndërkulturore të planifikuara, sistematike dhe të rregullta mund të përfshihen në përmbajtjen e obligueshme mësimore përmes lojërave të shkurtra hyrëse, aktiviteteve grupore, si pjesë e situatave të zgjidhjes së problemeve, ose me përdorimin e muzikës, fotove ose videove. *(Si të arrihet arsimimi ndërkulturor, 2018).*

Personeli mësimor, shërbimet profesionale dhe menaxhmenti i shkollës duhet të krijojnë strategji ndërkulturore (afatshkurta dhe afatgjata) për elementet ndërkurrikulare dhe qasje të vazhdueshme ekipore për promovimin e vlerave ndërkulturore në veprimtaritë edukative dhe arsimore.

Filozofia e arsimi ndërkulturor duhet të përfshihet në përmbajtjen e të gjitha lëndëve mësimore, me promovimin e vazhdueshëm të aspekteve të ndryshme të kulturave, pa u kufizuar në kontekstin lokal, por duke i integruar ato në nivel global.

Edukimi ndërkulturor nuk mund të reduktohet në paraqitjen dhe memorizimin e fakteve për disa kultura, gjuhë, tradita etj. Është një proces afatgjatë i zhvillimit të ndjeshmërisë ndërkulturore të nxënësve. Prandaj, do të ishte krejtësisht e pajustificuar, e gabuar dhe e paarsyeshme të pritet që njohuritë ndërkulturore të nxënësve të mund të vlerësohen në mënyrë sasiore dhe numerike. Sipas detyrave globale, arsimimi ndërkulturor duhet të përgatisë brezat e ardhshëm për të jetuar në mjedise të larmishme, falë qëndrimeve, vlerave dhe aftësive ndërkulturore të rrënjësura në të. *(Si të arrihet arsimi ndërkulturor, 2018).*

B) Arsimimi ndërkulturor në veprimtaritë jashtëkurrikulare

Përkrahja në planifikimin, organizimin dhe koordinimin e aktiviteteve që mund të pasurojnë cilësinë e jetës shkollore ndërkulturore është thelbësore për promovimin e parimeve demokratike si mosdiskriminimi dhe respektimi i dallimeve individuale. Përveç kësaj, aktivitetet që promovojnë ndërkulturalizmin mund të kontribuojnë në zhvillimin dhe pjesëmarrjen e plotë të nxënësve, në cilësinë dhe krahasueshmërinë ndërkombëtare të njohurive, gatishmërinë për të mësuar gjatë gjithë jetës, multikulturalizmin, përfshirjen, kompetencën, përgjegjësinë dhe partneritetin.

Aktivitetet e ndryshme jashtëkurrikulare dhe aktivitetet e projekteve janë platformë e rëndësishme për arritjen e këtij qëllimi në mjediset shkollore. Ato duhet të jenë, mbi të gjitha, pasqyrim i vlerave universale njerëzore që synojnë të mbështesin dialogun ndërkulturor, bashkëpunimin e bashkëjetesën dhe të rrisin interesat e nxënësve, afinitetet dhe potencialet e tyre.

Shkollat duhet të mbështesin procesin e funksionimit të drejtpërdrejtë të aktiviteteve të shumta jashtëkurrikulare, me synim promovimin e rolit edukativ, socializimin dhe trajnimin për bashkëpunim të suksesshëm në grupe apo çifte, si dhe hulumtime, zbulime dhe avancime të pavarura.

Përmbajtja e tyre rrjedh nga fusha të ndryshme si artet e bukura, filmi, fotografia, muzika, teatri, grafika dhe dizajni, mjedisi, edukimi për paqen, sporti, kultura urbane, edukata qytetare, shkenca dhe teknologjia.

Mbi të gjitha, projektet dhe aktivitetet e lira duhet të kontribuojnë në promovimin pozitiv të dallimeve të mëposhtme:

ETNIKE	KULTURORE	GJINORE	FETARE
GJUHËSORE	ZHVILLIMORE	SOCIO-EKONOMIKE	

(Si të arrihet arsimiti ndërkulturor, 2018)

Në të gjitha shkollat duhet të mbështetet realizimi i përmbajtjeve të aktiviteteve jashtëkurrikulare që kanë të bëjnë me promovimin e vlerave universale njerëzore dhe të mësuarit për dallimet socio-kulturore.

Nëpërmjet grupeve dhe klubeve të nxënësve, aktivitetet e projekteve shkollore ofrojnë mundësi për rrjetëzimin e ekipeve të nxënësve dhe mësuesve në nivel lokal ose rajonal në zbatimin e aktiviteteve afatgjata dhe të projekteve kërkimore, të cilat do të përmirësoheshin me qasje shumëgjuhëshe, mësim në distancë, ndërveprim dhe bashkëpunim të ndërsjellë.

Shkollat janë thelbësore në procesin e promovimit të rolit të aktiviteteve jashtëkurrikulare dhe të projekteve si pjesë e funksionimit të përgjithshëm të shkollës, të organizuar si njëfarë qendre lokale edukative dhe arsimore ndërkulturore plotësisht e hapur për nxënësit dhe prindërit e tyre. Shkollat duhet të insistojnë në zhvillimin e vendosur, të qëndrueshëm dhe të saktë të programit dhe hartimin e aktiviteteve jashtëkurrikulare dhe të projektit, në mënyrë që të ndërtojnë dhe mbështesin perceptimin pozitiv të diversitetit në shkollë dhe në mjedisin lokal. *(Si të arrihet arsimiti ndërkulturor, 2018)*.

PROMOVIMI I SUKSESSHËM I ELEMENTEVE NDËRKULTURORE SI NË AKTIVITETET E KURRIKULARE ASHTU EDHE ATO JASHTËKURRIKULARE VARET KRYESISHT NGA ZGJEDHJA E SAKTË E FORMAVE, METODAVE DHE TEKNIKAVE TË MËSIMDHËNIES NË PUNËN ME NXËNËS.

THEKSI DUHET VËNË NË APLIKIMIN E FORMAVE, METODAVE DHE TEKNIKAVE QË DO TË RRSIN NDËRVEPRIMIN, KOMUNIKIMIN, BASHKËPUNIMIN, TË MENDUARIT KRITIK DHE FLEKSIBIL, KURESHTJEN DHE NDJESHMËRINË MES STUDENTËVE. KJO MUND TË ARRIHET ME PËRDORIMIN OPTIMAL DHE TË BALANCUAR TË PUNËS INDIVIDUALE, TË DYFISHTË DHE NË GRUP, TË AVANCUAR ME DISA METODA MËSIMORE, SI METODA E DIALOGUT, BISEDËS, ILUSTRIMIT, LOJËS, DEMONSTRIMIT DHE PUNËS PRAKTIKE. TEKNIKAT E SHUMTA DHE TË NDRYSHME TË MËSIMDHËNIES JANË MJET I RËNDËSISHËM PËR RRRITJEN E NDIHMËS RECIPROKE, SHKËMBIMIN E INFORMATAVE, PËRVOJAVE, QËNDRIMEVE, VLERAVE DHE IDEVE MES BASHKËMOSHATARËVE.

Dizajni dhe mjedisi pedagogjik ndërkulturor

Disa faktorë që lidhen ngushtë me mjedisin e shkollës, ambientin, atmosferën, kanë ndikim pozitiv në mbështetjen e dialogut ndërkulturor.

Ato duhet të shërbejnë si burime stimuluese të diversitetit që përfaqësohen dhe promovohen pozitivisht. **Mjedisi shkollor duhet të jetë i lehtë për tu përshtatur**, duke ndjekur të gjitha tendencat aktuale me karakter lokal, kombëtar apo global, por me shenjë ndërkulturore.

Hapësirat e ekspozitave në shkollë duhet të përmbajnë **mesazhe pozitive, inkurajuese, stimuluese, moto, foto, ilustrime, aplikacione dhe përmbajtje**, të cilat promovojnë vlera të ndryshme kulturore, gjuhë, simbole.

Nxënësve duhet t'iu ofrohet një shumëllojshmëri e **mjeteve didaktike, mjeteve ndihmëse dhe burimeve audio-vizive** që pasqyrojnë veçoritë dhe vlerat e kulturave dhe traditave të ndryshme.

Mjedisi i klasës duhet të ofrojë mbështetje shtesë për bashkëpunimin në ekip dhe në çifte ndërmjet nxënësve, mësuesve dhe prindërve. Ai gjithashtu duhet të jetë shumëfunktional dhe t'u shërbejë si nevojave të procesit të edukimit dhe arsimit të obligueshëm ashtu edhe nismave të ndryshme për nxitjen e dialogut ndërkulturor. Klasa duhet të organizohet si qendër e vogël e hapur për mësim, shoqërim dhe punë kreative. Ndërveprimet, atmosfera pozitive, klima socio-emocionale në klasë mund të forcohen nga **organizimi i disa këndeve fleksibile** (p.sh., kreative, të leximit, të lojës, të zgjidhjeve të konfliktit, relaksimit, këndi i ditëlindjeve, etj.), që janë gjithmonë të hapura për të gjitha llojet e diversitetit.

Tendenca dhe prioriteti i çdo institucioni edukativo-arsimor duhet të jetë mbështetja e nismave për **projektimin e klasave ndërkulturore, të cilat do të pasqyrojnë diversitetin etnik, kulturor, gjuhësor dhe gjinor, si brenda kornizave lokale ashtu edhe atyre globale**. Këto elemente pritet të ofrojnë përkrahje për një vetë-imazh pozitiv të çdo subjekti edukativ dhe arsimor, si dhe të mbështesin perceptimin pozitiv të diversitetit në mjedisin e afërt.

Për të parandaluar ikonografinë e papërshtatshme të shkollës, vëmendje dhe theks i veçantë duhet t'i kushtohet zgjedhjes së:

- ilustrimeve dhe simboleve që duhet të jenë përfaqësuese të individëve dhe grupeve me përkatësi të ndryshme etnike dhe kulturore, si dhe të moshave, gjinive apo kategorive të ndryshme shoqërore, të cilat do të prezantohen në mënyrë të balancuar në të gjithë hapësirën e shkollës;
- burimeve ilustruese që duhet të promovojnë pozitivisht personat me nevoja të veçanta si pjesë e mjedisit ndërkulturor dhe akterëve aktivë të tij;
- mesazheve të shkruara, informatave, njoftimeve dhe shpalljeve të cilat duhet të pasqyrojnë diversitetin gjuhësor, në mënyrë që të mbështesin interesin për zbulimin dhe mësimin e shumë gjuhëve.

Projektimi i duhur i të gjithë hapësirës së shkollës është shumë i rëndësishëm, duke ditur se është mesazhi i parë dhe më i spikatur që u dërgohet të gjitha subjekteve të përfshira në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, si prindërit, familja e gjerë e nxënësit, partnerët nga komuniteti lokal, etj.



Kompetencat ndërkulturore

Personeli edukativo-arsimor luan rol vendimtar në arritjen e transformimit të vetes si dhe transformimin e institucioneve edukative dhe arsimore. Ata duhet të jenë të përgatitur për të lehtësuar në mënyrë efektive jetën shkollore për çdo individ, pavarësisht nga ngjashmëritë apo dallimet e tyre kulturore dhe duhet të luajnë një rol më aktiv në rivlerësimin e të gjitha praktikave edukative dhe arsimore dhe mënyrën se si ato ndikojnë te nxënësit. Prandaj, kompetencat e mësuesve që kërkohen për arritjen e dialogut efektiv ndërkulturor në procesin edukativo-arsimor dhe afirmimin e ndërkulturalizmit tek nxënësit luajnë një rol qendror në këtë proces.

Kompetencat ndërkulturore nënkuptojnë shkathtësi dhe karakteristika të ndryshme me të cilat secili prej nesh identifikohet në nivel individual dhe personal. Ato zakonisht klasifikohen në tri dimensione: kognitive, afektive/emocionale dhe të sjelljes/komunikuese. (Sablić, 2014).

Dimensionimi kognitiv i kompetencave ndërkulturore nënkupton aftësi në fushën e historisë, gjeografisë, shkencave natyrore, gjuhëve, letërsisë, arteve, etj., si përfaqësues të kulturave të ndryshme, të cilat ofrojnë pamje të gjerë, shumëkulturore të botës.

Dimensionimi afektiv/emocional i kompetencave ndërkulturore është shumë i rëndësishëm, pasi nënkupton vlera thelbësore të çdo individi, si vetëvlerësimi dhe vetëperceptimi pozitiv, të cilat janë parakushte për të qenë të hapur dhe kureshtar, por edhe për të njohur burimet e stereotipeve dhe paragjykimëve dhe refuzimin e tyre. Ndjeshmëria ndërkulturore nënkupton ndjeshmërinë emocionale ndaj personave me përkatësi të ndryshme kulturore dhe aftësinë për të perceptuar dhe njohur botëkuptime të ndryshme, të cilat do të mundësonin pranimin, si të identitetit personal ashtu edhe të vlerave kulturore të pjesëtarëve të komuniteteve të ndryshme.

Dimensionimi i sjelljes/komunikimit të kompetencave ndërkulturore përfshin përvojën personale, mënyrën e jetesës dhe komunikimin, etj. si bazë për formimin e perceptimeve për diversitetin. Nga kjo informatë do të varet shkalla dhe cilësia e ndërveprimit (komunikimit verbal dhe joverbal) me persona që i përkasin kulturave të ndryshme.

Kompetencat ndërkulturore të edukatorëve, mësuesve, bashkëpunëtorëve profesional dhe drejtorëve të shkollave do të mundësonin njohjen dhe pranimin më të lehtë të dallimeve, si dhe ndërveprimin e vazhdueshëm me to.. Kjo mund të

arrihet nëse një individ e njeh mirë kulturën e vet, por edhe veçoritë kulturore të të tjerëve dhe nëse ai zotëron edhe vetëdijen dhe ndjeshmërinë kulturore. Vetëm personi që i ka zhvilluar të dyja këto mund të inkorporojë me sukses dimensionin ndërkulturor në procesin edukativo-arsimor.

Kompetencat ndërkulturore përfshijnë kategoritë e mëposhtme:

- **Kompetencat personale dhe ndërpersonale:**
menaxhimi i kohës dhe emocioneve, mësimi, dëgjimi aktiv, zgjidhja e konflikteve, fleksibiliteti, vetëdija, vetëbesimi, vetëvlerësimi, aftësia për të punuar individualisht ose në grup, bashkëpunimi, komunikimi i suksesshëm dhe efektiv, vendosmëria, përkushtimi etj.
- **Kompetencat ndërkurrikulare:**
planifikimi, programimi, integrimi i përmbajtjeve kurrikulare dhe aktiviteteve jashtëkurrikulare, vetë-reflektimi, aplikimi efektiv i teknologjisë së informacionit dhe komunikimit në fushën e arsimit të integruar, hulumtimi, përzgjedhja dhe analiza e informatave dhe njohurive rreth procesit të zbatimit, etj.
- **Aftësitë kognitive dhe kreative:**
zgjidhja e problemeve, të menduarit kritik, vendimmarrja, parafrazimi, inovacioni, origjinaliteti, fleksibiliteti, të menduarit ndryshe, etj.

(Koncepti për Arsimin Ndërkulturor, 2016)

Zhvillimi i kompetencave ndërkulturore duhet të jetë proces i vazhdueshëm dhe afatgjatë i organizuar përmes disa niveleve të njëpasnjëshme të trajnimit që do të mundësonte përvetësimin, avancimin, përmirësimin dhe rifreskimin e kompetencave, shkathtësive dhe aftësive të fituara për arsimimin ndërkulturor.

Përkrahja e zhvillimit të kompetencave ndërkulturore të personelit edukativo-arsimor do të ndikojë drejtpërdrejt në zhvillimin e këtyre kompetencave te nxënësit. Elementet e kompetencave ndërkulturore janë të lidhura ngushtë dhe të rrënjësura në të gjashtë kompetencat kryesore të arsimit parauniversitar në Kosovë, gjë që tregon qartë nevojën për një qasje të përgjithshme në promovimin e arsimit ndërkulturor.

Modelet e edukimit ndërkulturor dhe aktiviteve edukative

Zhvillimi i aftësive ndërkulturore të nxënësve fillon kryesisht nga ndërtimi i një imazhi pozitiv për veten dhe identitetin e tyre, duke zhvilluar respektin dhe ndjeshmërinë ndaj tjerëve si dhe vlerësimin e diversitetit përmes komunikimit, bashkëpunimit, gatishmërisë për të ndarë dhe ndihmuar të tjerët.

Trajtimi i ndërkulturalizmit në shkollë ndihmon në përgatitjen e nxënësve për të respektuar dhe promovuar vlerat e një shoqërie demokratike në situata dhe mjedise të ndryshme sociale, si në shkolla, lagje dhe brenda grupeve të ndryshme. Ndërkulturalizmi në shkollë mund të bëhet pjesë e punës së përditshme, si frymë, metodologji mësimore dhe përmbajtje mësimore.

Temat që lidhen me ndërkulturalizmin mund të zbatohen përmes lëndëve (si çështje ndërkurrikulare), aktivitete jashtëkurrikulare dhe lëndë zgjedhore. Lëndët që rrjedhin nga fushat kurrikulare/mësimore si Shoqëria dhe Mjedisi (Shkencat Shoqërore), Gjuhët dhe Artet ofrojnë mundësi më të mëdha për t'u marrë me ndërkulturalizmin, për dallim nga lëndët që rrjedhin nga fusha të tjera kurrikulare.

Ky doracak ofron shembuj se si të trajtohet ndërkulturalizmi përmes aktiviteve dhe lojërave, si gjatë mësimëve ashtu edhe gjatë aktiviteve jashtëkurrikulare. Këto modele mund të shërbejnë si udhërrëfyes për ndërhyrje të tjera të mundshme ndërkulturore në edukim dhe arsim. Aktivitetet XI deri në XVI janë fokusuar në mënyrë specifike në kontekstin e Kosovës.

Përkthimi i të gjitha materialeve video është i disponueshëm në formën e titrave në YouTube dhe transkripteve të bashkangjitura në secilin aktivitet.



Fusha e kurrikulës: Matematika

Tema e programit: Matja dhe zgjidhja e problemit **(Klasat: I-IV)**

Qëllimet:

- Të njohin dhe të emërtojnë objektet përreth dhe karakteristikat e tyre sipas gjatësisë së tyre;
- Perceptojnë dhe emërtojnë objekte nga rrethina e afërt;
- Krahasojnë objektet sipas gjatësisë së tyre: të gjatë – të shkurtër, të lartë – të ulët.

Materiali: gërshtë, ngjitës, letër, zarfe ose enë, objekte me përmasa dhe gjatësi të ndryshme

Koha dhe hapësira: në klasë, 45 min

Struktura e propozuar e aktivitetit:

Nxënësit ndahen në mënyrë rastësore në disa grupe (p.sh. sipas ngjyrës së letrës të ngjitur nën karrigen e tyre), pas së cilës ata inkurajohen të zgjidhin enigma të bashku për të formuar gjirafa me gjatësi të ndryshme të qafës. **Shih Shtojcën 1**

Mësimdhënësi/ja i pret në disa pjesë fotografite nga shtojca 1, i vendos brenda një zarfi ose në enë dhe ua jep grupit të nxënësve. Në grup, nxënësit i bashkojnë pjesët dhe e plotësojnë fotografinë. Nëse dëshirojnë, mund t'i ngjisin pjesët së bashku në një copë letër.

Për ta bërë më të lehtë zgjidhjen, priten më pak pjesë.

Pasi të zgjidhin enigmën, nxënësit diskutojnë për dallimet në gjatësinë e qafës së gjirafave dhe dallimet në gjatësinë e tyre.

Në drejtim të sensibilizimit ndërkulturor të nxënësve, aktiviteti hyrës shoqërohet me një video të shkurtër ku prezantohet jeta dhe mjedisi natyror i gjirafave si specie shtazore. Shih transkriptin në **Shtojcën 2** (nëse është e nevojshme)



Të mësojmë për gjirafat

Nxënësit inkurajohen të përfshihen në një lojë didaktike: **Njohja objektit të shkurtër - të gjatë**. Në një kuti vendosen disa sende me gjatësi të ndryshme (p.sh. shall, metër, copë leshi, laps, lidhëse këpucësh, etj.). Kutia më pas kalohet dorë më dorë. Çdo nxënës duhet të zgjedhë një objekt dhe ta krahasojë atë me objektet e zgjedhura nga nxënësit e tjerë. Loja mund të luhet me meloditë e mëposhtme:



Nxënësit nxiten të punojnë individualisht në fletët e punës, përmes të cilave do t'u duhet të përcaktojnë dallimet në gjatësi dhe lartësi të objekteve të ndryshme, të kafshëve etj. **Shih Shtojcën 3**

Aktiviteti përfundon me lojën: **Rendit sipas lartësisë**. Nxënësit të ndarë në çifte përdorin kartolina me fëmijë me gjatësi të ndryshme dhe i renditin nga më i shkurti te më i gjati. **Shih Shtojcën 4**

Shtojca 1



Shtojca 2

Transkripti:

Të mësojmë për gjirafat. Me qafën e gjatë, e të gjatë dhe këmbët e gjata, gjirafat janë kafshët më të gjata në tokë. Disa gjirafa arrijnë gjatësinë prej më shumë se 5.18 metrave. Ato janë gjitarë, që do të thotë se janë gjaknxehtë, kanë gëzof dhe i ushqejnë foshnjat e tyre me qumësht. Gjirafat jetojnë në Afrikë, në jug të shkretëtirës së Saharasë, ato preferojnë të jetojnë në pyje ose kullota të hapura, ku hanë gjethet e pemëve që kafshët e tjera nuk mund t'i arrijnë. Gjirafat janë barngrënëse ose bimëngrënëse, ato mund të hanë gjethet nga pemët e akacies, sepse gjuha e tyre e gjatë dhe buzët e forta ua mundësojnë të hanë, përreth gjembave. Luanët ndonjëherë i vrasin dhe i hanë gjirafat, por zakonisht qafa e gjatë e gjirafave ua mundëson atyre t'i shohin rreziqet që vijnë dhe ato thjesht ikin përpara se të kapen nga luanët. Kjo është arsyeja pse gjirafat udhëtojnë në tufa, gjithmonë është dikush që e monitorin rrezikun.

Për të qenë të sigurt, gjirafat qëndrojnë në këmbë pothuajse gjatë gjithë kohës. Ato hanë në këmbë, flenë në këmbë, madje edhe i lindin të vegjlit e tyre ndërsa qëndrojnë në këmbë. Ju mund të mendoni se qafa e gjirafës ka shumë kocka, por kjo nuk është e vërtetë, ato në të vërtetë kanë vetëm shtatë kocka në qafën e tyre, që është i njëjti numër që ka njeriu, por të tyret janë shumë më të mëdha. Ndonjëherë gjirafat meshkuj zihen për atë se kush është shefi i tufës, ato luftojnë duke goditur qafën kundër njëritjetrit. Kjo mund të mos duket si luftim, por gjirafat mund të lëndohen shumë në këto përleshje.

Gjirafat nuk janë specie e rrezikuar, por ato nuk janë aq të zakonshme sa ishin më parë. Ju mund të mos e dini, por në fakt ka lloje të ndryshme gjirafash, ne mund ta vërejmë dallimin mes tyre duke i shikuar larat e tyre. Lloje të ndryshme të gjirafave, jetojnë në pjesë të ndryshme të Afrikës. Gjirafa që zakonisht shihet në kopshte zoologjike quhet gjirafë e rrjetëzuar, ku mund të dalloni modelin e larave të saj. Shpresoj se ju ka pëlqyer mësimi rreth gjirafave sot. Mirupafshim deri herën tjetër.

Shtojca 3







Emri _____

Data _____

Më e gjatë apo më e shkurtër?

Pritini dhe ngjitni etiketat në imazhin përkatës



Më i shkurtë

Më i gjatë

Më i shkurtë

Më i gjatë

Më i gjatë

Më i shkurtë





Më i gjatë

Më i shkurtë

Aktiviteti matës

Rrethoni imazhin më të shkurtër në secilën kuti dhe ngjyrosni atë

Emri _____



I gjatë apo i shkurtër?

Shikoni imazhet dhe përgjigjuni pyetjeve

Emri _____



Shtojca 4



Fusha e kurrikulës: Shoqëria dhe mjedisi

Tema e programit: Familja ime e ngushtë **(Klasat: I-V)**

Qëllimet:

- Të kuptohet roli dhe rëndësia e familjes;
- Të shprehen emocionet për familjet e tyre (në mënyrë verbale dhe joverbale);

Materiali: gërshtë, ngjitës, letër, zarfe ose enë, materiale të ndryshme për të bërë dhe dekoruar kornizat për fotografi

Koha dhe hapësira: në klasë, 45 min

Struktura e propozuar e aktivitetit:

Aktiviteti fillon duke i ndarë nxënësit në grupe; pas kësaj, nxënësit brenda secilit grup inkurajohen të zgjidhin enigmën që përmban familje nga pjesë të ndryshme të botës. **Shih Shtojcën 1**

Mësimdhënësi/ja i pret në disa pjesë fotografite nga shtojca 1, i vendos brenda një zarfi ose ene dhe ia jep grupit të nxënësve. Në grup, nxënësit bashkojnë pjesët dhe plotësojnë fotografinë. Nëse dëshirojnë, mund t'i ngjisin pjesët së bashku në një copë letre.

Për ta bërë më të lehtë zgjidhjen, priten më pak pjesë.

Theksohet se çdo mozaik përfaqëson një bashkësi të caktuar familjare, pas së cilës secili nxënës fillon të vizatojë familjen e tij dhe të dekorojë portretin e familjes në kornizën e bërë nga materiale të ndryshme nga natyra.

Nxënësit inkurajohen të paraqesin portretet e tyre familjare dhe t'i vendosin në këndin e familjes në klasë.

Kjo pasohet nga prezantimi i video materialit të shkurtër që përmban familje nga vende të ndryshme të botës, në të kaluarën dhe tani




Fëmijët & Familjet
Perreth botës



Familjet e të gjitha
llojeve

Aktiviteti mund të pasurohet me prezantim të vendbanimeve dhe shtëpive të fëmijëve në mbarë botën (dhe identifikimin e shtëpive tipike në kontinente të ndryshme, zona rurale/urbane, etj.).

Shtojca 1







Fusha e kurrikulës: Artet

Tema e programit: Të dëgjuarit e muzikës **(Klasat: I-V)**

Qëllimet:

- Të njohë ritmin, tampon dhe dinamikën në një kompozim muzikor;
- Ndiqni ritmin e dhënë;
- Të dallojë tempin në një kompozim muzikor (ngadalë – shpejt);
- Të dallojë dinamikën në një kompozim muzikor (e zëshme- e butë);
- Ta përdor ritmin duke luajtur në instrumentet muzikore të fëmijëve.

Materiali: letër, gërshtë, lapsa ngjyrosës ose shkumësa, ngjitës, kuti ose enë

Koha dhe hapësira: në klasë, 45 min

Struktura e propozuar e aktivitetit:

Aktiviteti nis me prezantimin e pjesëve të shkurtra muzikore me tempo dhe dinamika të ndryshme.

Nxënësit inkurajohen që t'i njohin ato sipas ritmit të tyre dhe të ngrenë shenjë përkatëse (lepuri - tempo e shpejtë, breshka - tempo e ngadaltë). **Shih Shtojcën 1**




Për ta theksuar Dallimi mes ritmit të shpejtë dhe ritmit të ngadaltë, nxënësit dëgjojnë Ninullën nga Brahms

Pas kësaj ata përpiqen të gjejnë foton e duhur që i përgjigjet pjesës muzikore në mesin e fotove të ndryshme të ngjarjeve ose krijesave të caktuara. **Shih Shtojcën 1**

Fokusi vendoset në një ritmin e ninullës, pavarësisht nga gjuha ose vendi i origjinës së kompozimit muzikor.

Nxënësit inkurajohen të zbulojnë rolin dhe qëllimin e këtyre kompozimeve.

Inkurajohen të ndajnë përvoja dhe kujtime personale të ninullave nga familjet e tyre.



Nina nana, ninna oh **Dandini Dastana ve Fiş Fiş Kayıkçı** **Uspavanka - Spava moja beba**

Loja përfundon me lojën muzikore-motorike: **Ndiqni Ritmin**. Nxënësit organizohen në disa grupe me 4-5 veta, duke qëndruar pas njëri-tjetrit. Secili grup duhet të përpiqet të ndjekë ritmin e dhënë nga kompozime të ndryshme muzikore me hapa dhe lëvizje të koordinuara të vendosura nga nxënësi i parë në kolonë.

Sugjerim shtesë



Pasi të lajmërohet një ninullë nga Japonia, secili student mund të marr pjesë në krijimin e jastëkut Ojami, si simbol i gjumit dhe ëndrrave të ëmbla (duke përdorur fasule dhe copa pëlhure, duke i lidhur në pjesën e sipërme).

Shënim: mësuesi mund të gjejë ide shtesë për lojëra me jastëkë Ojami duke ndjekur këtë link.

Aktiviteti mund të plotësohet duke kaluar jastëkun Ojami nga dora në dorë, sipas ritmit të ninullës.

Shtojca 1



Fusha e kurrikulës: Gjuha dhe komunikimi

Tema e programit: Përrallat **(Klasat: I-V)**

Qëllimet:

- Të thellojë interesimin dhe kureshtjen e nxënësve për letërsinë e fëmijëve;
- Të zbulojnë personazhet kryesore në përralla dhe veçoritë e tyre;
- Të nxiten nxënësit për tu shprehur me shkrim dhe për të krijuar.

Materiali: kapelë ose shall i kuq, maskë ujku, kuti ose enë, letër, lapsa ngjyrosës, markerë, distinktivë/letra me emrat e personazheve nga tregimi i Peter Pan

Koha dhe hapësira: në klasë, 45 min

Struktura e propozuar e aktivitetit:

Aktiviteti mund të fillojë me lojën **Kësulëkuqja dhe Ujku**.

Një nxënës është në rolin e Ujku, ndërsa të tjerët imitojnë Kësulëkuqen duke lëvizur, duke kërcyer, duke mbledhur lule, duke vrapuar etj. Kur mësimdhënësi jep sinjal (p.sh. duartrokite), nxënësi në rolin e Ujku, i cili më parë ishte ulur në një cep të dhomës, fillon të vrapojë, duke u përpjekur ta etiketojë një nga nxënësit në rolin e Kësulëkuqes. Studenti i etiketuar më pas e merr rolin e Ujku. Loja përsëritet disa herë.

Për lojën e radhës mësimdhënësi/ja përgatit një kuti që përmban letra me udhëzime të ndryshme. Me radhë, nxënësit zgjedhin një letër dhe lëvizin sipas asaj që është shkruar në të.

Instructions:

- Kërceni në njërin këmbë aq herë sa numri i motrave të Hirushes.
- Prekni diçka me të njëjtën ngjyrë si ngjyra e fustanit të Tinker Bellit.
- Goditni tokën me këmbë aq herë sa numri i edhave që ishin në shtëpi kur trokiti ujku.
- Bëni përpara aq hapa sa ka fjalë në titullin e tregimit për Lizën.
- Kape veshin e majtë aq herë sa janë takuar arinjtë ngjyrë ari.
- Thërrisni "HO" aq herë sa numri i xhuxhëve që jetuan me Borëbardhën.

- Thuaj aq emra sa numri i personazheve në tregimin e Kësulëkuqes.
- Prekni tre artikuj që janë bërë nga i njëjti material që përdori plaku Geppetto për të krijuar djalin e vogël.
- Rendisni dy histori me një personazh shtrige dhe kthehuni dy herë.

Nxënësit ndahen në dyshe dhe secila dyshe nxitet të bëjë një krahasim mes dy përrallave të ndryshme duke përdorur teknikën e Diagramit të Venit.

Shih Shtojcën 1

Për shembull:

Ujku dhe tre derrat dhe Kësulëkuqja; Bukuroshja e fjetur dhe Hansel e Gretel; Goldilocks dhe tre arinjtë dhe Liza në botën e çudirave; Pinoku dhe rosaku i shëmtuar; Ujku dhe shtatë edhat dhe Borëbardha dhe shtatë xhuxhët, etj.

Në këtë aktivitet, njëri rreth do të përmbajë informacion për një përrallë, rrethi tjetër do të përmbajë informacion për përrallën tjetër, ndërsa informacioni që është i përbashkët për të dyja përrallat do të vendoset në zonën ku rrathët mbivendosen.

Pasi theksojnë ngjashmëritë dhe dallimet mes përrallave, nxënësit organizohen në katër grupe dhe nxiten të krijojnë katër përralla të reja dhe origjinale. Ata janë të lirë të fusin elementë të rinj, ose elementë nga histori të tjera.

Titujt e mundshëm të përrallave:

- Si e mposhti Kësulëkuqja Ujkun?
- Tre derrat e vegjël, shtatë edhat dhe vetëm një ujku
- Pse bukuroshen e fjetur nuk e zuri gjumi?
- Hansel dhe Gretel takojnë Borëbardhën

Nxënësit fillojnë të shkruajnë bazuar në titullin e tregimit, krijojnë përralla të reja moderne dhe më pas i lexojnë para shokëve të klasës.

Aktiviteti mund të mbyllet me lojën **Peter Pan**:

Secili pjesëmarrës në lojë merr një distinktiv me një emër ose ilustrim të një personazhi nga historia e Peter Panit. Vetëm një fëmijë mund të marrë rolin e kapitenit Gremç, ndërsa personazhet e tjerë mund të përsëriten disa herë, dmth: Uendy, Tinker Bell, Majkëll, George, indianët, etj.

Nxënësit lëvizin në mënyra të ndryshme ndërsa muzika është duke luajtur (duke ecur në gishta të këmbës, duke kërcyer në njërën ose të dyja këmbët, etj.), derisa fëmija që imiton piratin të bërtet me zë të lartë: Kapiten Gremçi! Të gjithë ndalojnë dhe përpiqen të kapin dorën e njëri-tjetrit sa më shpejt të jetë e mundur. Anëtari i grupit që përfundimisht do të mbetet vetëm, merr rolin e piratit. Rekomandimet: Loja ndikon pozitivisht në forcimin e kohezionit në grup. Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet parandalimit të rishfaqjes së disa fëmijëve në rolin e piratit, veçanërisht atyre nxënësve që zakonisht janë të izoluar nga grupi. **Shih Shtojcën 2**


Rekomandime dhe udhëzime lidhur me aspektet ndërkulturore



Nxënësit mund të shikojnë një video prezantim shtesë për kështjellat më të famshme në mbarë botën, si ndërtesa që gjenden në shumë përralla. **Shih shtojcën 3**


Ata mund të përpiqen të gjejnë vendet ku ndodhen kështjellat dhe t'i shënojnë ato në një hartë.

Shtojca 1



Shtojca 2





Shtojca 3

10 kështjella të mrekullueshme të përrallave nga e gjithë bota:

Kjo është lista e disa prej kështjellave më të bukura dhe më mbresëlënëse që edhe sot e kësaj dite duken sikur të ishin marrë nga një libër përrallash.

Alcazari i Segovias, Spanjë

Alcazar i Segovias, është pallat i veçantë i vendosur në majë të maleve Guadarrama. E ndërtuar mbi themelet romake, ajo u përdor si pallat mbretëror, kolegji mbretëror i artilerisë, burg shtetëror dhe gjithashtu si akademi ushtarake.

Kalaja Bobolice, Poloni

Kalaja mbretërore Bobolice është një nga kështjellat më të bukura në Shtegun e Foleve të Shqiponjave. Ajo ka qenë dëshmitare e një historie të stuhishme dhe iu është nënshtruar një metamorfoze të jashtëzakonshme. Viteve të fundit, kjo kështjellë me pamje përrallore u rindërtua me përpikëri, në mënyrë që prosperiteti i saj të shihej edhe një herë në shkëlqimin e saj të plotë.

Kalaja Buzov, Republika Çeke

Kalaja Bouzov është nga kështjellat më të vizituara në Republikën Çeke dhe kështjellë e mrekullueshme që i ka qëndruar gjithë historisë së saj. U ndërtua në një kodër në Moravia, Republikën Çeke, si fortesë gotike në fillim të shekullit të 14-të. Kjo kështjellë përrallash është atraksion i madh turistik në Republikën Çeke, duke ofruar turne të ndryshme dhe madje edhe ekspozitë të dragonjve dhe vrasësve të dragonjve, kushtuar dragonjve të përrallave me përmasa reale dhe kalorësve që i luftuan.

Kalaja Cochem, Gjermani

Në përgjithësi supozohet se Kalaja Cochem u ndërtua rreth vitit 1000 nga konti palatinator Ezzo, djali dhe pasardhësi i kontit palatinator Hermann Pusilius. Kalaja kishte histori të gjatë dhe të larmishme derisa mbreti francez Luigji XIV urdhëroi që trupat e tij ta shkatërronin atë në vitin 1689. Kalaja mbeti gërmadhë me gurë të larmishëm për 180 vjet derisa biznesmeni i pasur nga Berlioni Louis Ravené vendosi t'i blinte rrënojat dhe ta rindërtonte kështjellën në vitin 1868.

Kalaja Corvin, Rumani

Kalaja Corvin, e njohur edhe si Kështjella e Hunyadit, është ndërtuar gjatë shekullit të 14-të dhe konsiderohet si një nga ndërtimet mesjetare më mbresëlënëse në Rumani. Kjo kështjellë e bukur përrallore përmban një Sallë luksoze të Kalorësve, një urë lëvizëse mbresëlënëse, mbështetëse të larta dhe oborre të brendshme, të gjitha të zbukuruara me artin mesjetar.

Kalaja Glucksburg Gjermani

Kalaja e Glücksburg është shtëpi stërgjyshore e Dukës së Schleswig-Holstein-Sonderburg-Glücksburgut dhe është përdorur herë pas here nga mbretërit danezë. E njohur me nofkën Wasserschloss ('kështjella e ujit') për shkak të pozicioniimit të saj në mes të një liqeni, ajo është një nga kështjellat më të rëndësishme të Rilindjes në Evropën veriore. Kalaja u ndërtua nga viti 1582 deri në vitin 1587 nga Nikolaus Karie për Johnin e II-të, Duka i Schleswig-Holstein-Sonderburgut, në vendin e një manastiri të mëparshëm.

Kalaja Hohenzollern, Gjermani

Kalaja Hohenzollern ndodhet në majën e një kodre suabiane me pamje nga qyteti i vogël i Hechingenit në Gjermani. Ndërsa themelet e saj janë të vjetra njëmijë vjet, kështjella është sulmuar, shembur, ndërtuar dhe rindërtuar, duke u përballur dy herë me bombardime të furishme nga katapultët, harkëtarët dhe shpatatarët. Kjo kështjellë idilike duket sikur

është nxjerrë direkt nga përrallat, me kullat e saj të larta dhe shtatë portat e njëpasnjëshme.

Kalaja Neuschwanstein, Gjermani

Kalaja Neuschwanstein ndodhet në Bavari të Gjermanisë dhe është ndërtuar në shekullin e 19-të për Mbretin Ludwigun e II-të të Bavarisë, i njohur gjithashtu si “Mbreti i përrallave”. Sot Neuschwanstein, “Kështjella e mbretit të përrallave”, është më e njohura nga të gjitha pallatet dhe kështjellat në Evropë, e cila vizitohet çdo vit nga 1.4 milionë njerëz.

Kalaja Ooidonk, Belgjikë

E vendosur në lumin Lys në Belgjikë, Ooidonk është shembull i jashtëzakonshëm i kështjellës së Rilindjes Flamane të ndërtuar në shekullin 13-14 nga Lordët e Neveles. Kalaja u shkatërrua plotësisht nga trupat e Maximilianit të Austrisë në vitin 1491, por u rindërtua në vitin 1501. Kalaja u dogj përsëri në vitin 1579 gjatë luftërave fetare dhe u rindërtua në stilin flaman-spanjoll që e shihni sot.

Kalaja Wernigerode, Gjermani

Kalaja Wernigerode (Schloss Wernigerode) ka pamje mahnitëse e ndërtuar gjatë shekullit të 12-të që mund t'i bëjë disa të ndihen sikur janë transportuar në një botë përrallore. Kalaja u rindërtua në një kështjellë të Rilindjes, në shekullin e 16-të dhe më pas u rindërtua në stilin barok si rezidencë romantike kështjellë gjatë shekullit të 17-të.

Fusha e kurrikulës: Shkencat e natyrës

Tema e programit: Drita (**Klasat: I-V**)

Qëllimet:


- Të dallohen burimet e dritës;
- Të kuptohet rëndësia e Diellit për jetën në Tokë;
- Të dallohen dy lloje të burimeve të dritës (natyrore dhe artificiale);
- Të inkurajohen që të krijojnë dhe mbajnë komunikim dhe bashkëpunim konstruktiv në klasë

Materiali: letër, lapsa për ngjyrosje, lapsa të mprehtë ose markera, letër, ngjitës, blloqe ndërtimi

Koha dhe hapësira: në klasë, 45 min


Struktura e propozuar e aktivitetit:

Nxënësit luajnë lojën **Qëlloni pa shikuar**, e cila çon në temën e aktivitetit. Nxënës të përzgjedhur më parë i mbulohen sytë me shall në mënyrë që ai/ajo nuk mund të shohë asgjë. Njëri student bën zhurmë ndërsa nxënësi me sy të mbuluar duhet të hamendësojë se nga vjen zhurma. Loja luhet disa herë. Ilustrimet sugjerojnë se mund të shohim falë dritës që vjen nga dielli, hëna, zjarri, yjet, elektriku i dorës ose llambat elektrike.



Nxënësve u jepen shpjegime për burimet e dritës përmes një video-prezantimi (linku më poshtë) i cili shpjegon se çka është drita, si na ndihmon t'i shohim objektet në natyrë dhe se pa dritë do të kishim errësi absolute. Gjithashtu dihet se ekzistojnë dy lloje burimesh dritë, dmth., natyrore dhe artificiale. Gjithashtu mund të theksohet se nuk ka jetë pa dritë. Shikoni informacionin kryesor në

Shtojcën 1




Nxënësit ndahen në tre grupe. Secili grup merr detyrë të ndryshme (shih më poshtë). Mësimdhënësi ndihmon dhe udhëzon grupet nëse është e nevojshme.

- Grupi i parë e pret një fotografi të Diellit, të cilin nxënësit do ta përdorin për të krijuar maskë.
- Grupi i dytë bashkon pjesë të një fotografie të poçit elektrik, në mënyrë që të krijoj një fotografi të plotë.
- Grupi i tretë bashkon blloqe ndërtimi për të krijuar një qiri.

Loja e mëposhtme mund të organizohet si aktivitet përfundimtar: **“Ditë-natë”**

Nxënësit duhet të ndjekin udhëzimet e dhëna nga mësimdhënësi, i cili vendos se cilat udhëzime do të përdoren në lojë dhe si. Për shembull, kur mësimdhënësi thotë “ditë”, nxënësit duhet të ngrihen në këmbë, dhe nëse ai/ajo thotë “natë”, nxënësit duhet të ulen. Ndryshim i lehtë i lojës: pas udhëzimit “ditë”, nxënësit mund të drejtojnë trupin e tyre derisa qëndrojnë ulur, dhe pas udhëzimit “natë” mund të mbështeten në tavolinë.

Rekomandime dhe udhëzime lidhur me aspektet ndërkulturore



Nxënësit mund të shikojnë video rreth jetës dhe shpikjeve të Thomas Edison, i cili shpiku poçin e parë elektrik në vitin 1880. **Shtojca 2**

Mini Bio -
Thomas Edison

Shtojca 1: Video rreth dritës

- Ne na nevojitet drita që të mund të shohim
- drita është formë energjie e përbërë nga fotonet
- fotoni është njësia më e vogël e dritës së dukshme
- si udhëton drita? drita sillet edhe si grimcë edhe si valë, dhe sillet ndryshe me lloje të ndryshme të materies
- nëse drita godet një objekt dhe kalon përmes tij, ai objekt njihet si objekt transparent (për shembull, nëse marrim një gotë ujë dhe ndezim një elektrik dore, drita kalon nëpër të dhe kjo dëshmon se uji është transparent)
- ka objekte të caktuara nëpër të cilat drita nuk mund të kalojë dhe ajo ndryshon rrugën e saj pas goditjes së objektit. Këto objekte quhen objekte të padepërtueshme. Të tilla si: druri, telefoni celular, njerëzit etj.
- disa objekte lejojnë që drita të kalojë pjesërisht nëpër to dhe ato njihen si objekte të tejdukshme, si p.sh.: plastika, letra me gjalpë (letër pjekjeje) dhe xhami i ngrirë.
- drita udhëton më shpejtësinë më të madhe, në vakum ku nuk ka pengesë drita udhëton me një shpejtësi prej më shumë se 0.16 milion kilometra në sekondë
- duhen 8 minuta që rrezet e diellit të arrijnë në tokë
- kur drita udhëton nëpër medime të ndryshme ajo ngadalësohet dhe nganjëherë lakohet dhe ky lakim i dritës njihet si përthyerje. Nëse marrim një enë të mbushur me ujë dhe vendosim një laps në të, mund të shohim një lakim të lapsit. Lapsi nuk është lakuar, vetëm se rrezet e dritës janë përthyer.
- njerëzit janë biolumineshent, që do të thotë se ata emetojnë dritë, por shkëlqimi i tyre është 1000 herë më i dobët se sa mund të regjistrojë syri i lirë.
- Dritës i duhen afërsisht 1.2 sekonda për të arritur në hënë nga toka

Shtojca 2: Thomas Edison

Thomas Edison lindi më 11 shkurt 1847 në Milan (Ohio, SHBA). Në moshë të re, familja e Edisonit u zhvendos në Port Huron (Michigan), ku ai kaloi pjesën e mbetur të fëmijërisë së tij. Çuditërisht, Thomas Edison kishte vështirësi në shkollë, por ai arriti ta përmirësonte leximin dhe eksperimentin e tij që po bëhej nga nëna e tij, e cila e mësoi atë në shtëpi. Në moshën 15-vjeçare, Edison u bë telegrafist, duke dërguar dhe pranuar mesazhe me kodin e morsit, alfabet që përdor klikime të ndryshme për secilën shkronjë.

Edison shpesh argëtohej duke i demontuar gjërat për të parë se si funksiononin, dhe së shpejti ai vendosi të bëhej shpikës. Në vitin 1870, Edison u transferua në New York City dhe përmirësoi klikuesin e aksioneve. Së shpejti ai e krijoi kompaninë e tij që prodhonte klikues të ri për aksione. Ai gjithashtu filloi të punojë në përmirësimin e Telegrafit dhe shpiku një version që mund të dërgonte katër mesazhe në të njëjtën kohë.

Edison u zhvendos me familjen e tij në Menlo Park (New Jersey), ku e krijoi laboratorin e tij të famshëm.

Në vitin 1877, Edison shpiku fonografin (gramafonin). Fonografi ishte makinë që regjistronte dhe luante tinguj. Ai në fakt e përsosi gramafonin duke regjistruar “Mary kishte një qengj të vogël” në një copë fletë metalike. Një vit më vonë, Edison shpiku llambën si dhe sistemin e rrjetit të energjisë, i cili mund të gjeneronte energji elektrike dhe ta dërgonte atë në shtëpi përmes një rrjeti telash.

Me ato shpikje, ai e themeloi kompaninë Edison Electric Light Company në tetor të vitit 1878. Edhe pasi fitoi famën dhe pasurinë e madhe, Thomas Edison vazhdoi të shpikte, përmirësonte produkte dhe të jepte kontribut të rëndësishëm në teknologjinë e rrezeve X, baterive akumuluese dhe madje edhe filmave. Ai madje shpiku kukullën e parë që flet. Thomas Edison regjistroi 1093 patenta dhe shpikjet e tij ndryshuan botën përgjithmonë duke e bërë atë të njohur si shpikësi më i madh i Amerikës.

Fusha e kurrikulës: Shkencat e natyrës; Edukatë fizike, sport dhe shëndet

Tema e programit: Forcat dhe lëvizja (**Klasat: VI-IX**)

Qëllimet:

- Mëson si të llogaris shpejtësinë bazuar në të dhënat e distancës dhe kohës;
- Llogaritë shpejtësinë dhe nxitimin mesatar;
- Kryen matjet me saktësinë e duhur;
- Përdor siç duhet lloje të ndryshme të pajisjeve;
- Shfaq rezultatet në mënyrë të duhur në tabela, diagrame dhe grafikone;
- Kryen llogaritje të thjeshta;
- Identifikon rezultatet me devijime dhe propozon përmirësime në hulumtim.

Materiali: letër, lapsa për t'u ngjyrosur, lapsa të mprehtë ose markerë, shirit matës

Koha dhe hapësira: klasë dhe sallë sportive ose hapësira të jashtme, 45 min

Struktura e propozuar e aktivitetit:

Nxënësit ndahen në grupe të vogla. Mësimdhënësi/ja e pret në disa pjesë fotografinë nga shtojca 1, e vendos brenda një zarfi ose ene dhe ia jep grupit të nxënësve. Në grup, nxënësit bashkojnë pjesët dhe plotësojnë fotografinë. Nëse dëshirojnë, mund t'i ngjisin pjesët së bashku në një copë letre. Për ta bërë më të lehtë zgjidhjen, priten më pak pjesë. **Shih Shtojcën 1**

Pasi të gjitha grupet ta bashkojnë mozaikun, mësimdhënësi zbulon flamurin e Xhamajkës, i ndjekur nga videoja për rekordin e U. Bolt.



Rekordi i Usain Bolt në 100 metra

Gratë më të shpejta 100 metra

Aktiviteti mund të përmirësohet duke paraqitur videon e U. Bolt kur e thyen rekordin botëror dhe duke shikuar video rreth thyerjes së rekordeve botërore në 100 m në të kaluarën (burra/gra)

- Sa është distanca që mund ta kaloni në 10 sekonda? Luaj videon e Usain Bolt të rekordit botëror të vrapimit në 100 m prej 9,58 sekondash. Diskutoni se si kjo shifër tregon vetëm kohën, jo edhe shpejtësinë. Si e dimë që ai është njeriu më i shpejtë në Botë?

Çojini nxënësit në një vend ku mund të kalojnë distanca mjaft të gjata (p.sh., jashtë ose në sallën e sportit).

Shpjegojuni nxënësve se ata do të eksplorojnë distancën që mund të kalojnë në 10 sekonda. Kujtojuni atyre për rëndësinë e mbledhjes së rezultateve në mënyrë të organizuar.

Tabelë - për nxënësit individual

Aktiviteti	Distanca e kaluar për 10 sekonda
Ecje	
Vrapim	
Kërcim	
Kërcim me njërën këmbë	
Biçikletë	
Skateboard	

Kërkojuni të krijojnë një tabelë për t'i vendosur rezultatet. Nëse është e nevojshme, mund të përdoret si shembull tabela e mëposhtme.

Nxënësit do të kryejnë aktivitete të ndryshme si vrapim, ecje, kërcim ose hapërim për 10 sekonda. Nxënësit duhet të matin distancën e kaluar gjatë çdo aktiviteti dhe të shkruajnë rezultatet në tabelë. Pas kësaj, ata do të mund të llogarisin distancën mesatare të kaluar për 10 sekonda për secilin aktivitet.

Nxënësit kthehen në klasë dhe diskutojnë rezultatet. A ishte ky një test i drejtë? Sa ishin të sakta matjet? A kishte ndonjë rezultat që devijonte? Si mund ta përmirësojmë hulumtimin tonë?

Mësimdhënësi arrin në përfundim se shpejtësia mund të llogaritet duke përdorur të dhënat e distancës dhe kohës.



Aktiviteti mund të mbyllet me një ushtrim të vogël për zgjidhje të problemit : nxiten nxënësit të emërtojnë kafshë të cilave Usain Bolt mund t'ua kalojë. Kjo detyrë mund të realizohet në grup, me prezantimin e videos së mëposhtme e cila do të japë përgjigje rreth pyetjes.

Duke punuar së bashku, nxënësit gjithashtu mund të llogarisin shpejtësinë e atletëve që thyjnë rekorde e 100 m (në periudha dhe gara të ndryshme) dhe të përgatisin një pasqyrë statistikore të 100 metrave të medaljeve e arit / argjendit / bronzit të fituara nga atletë nga vende të ndryshme.

Annex 1



VII

Fusha e kurrikulës: Artet

Tema e programit: Ritëm **(Klasat: IV-IX)**

Qëllimet: Studenti duhet:

- Të njohë elementet e artit në objektet e përditshme;
- Kombinoj forma të natyrës për dekorimin e objekteve të përditshme;
- Njihet me konceptin e ritmit dhe e zbaton atë përmes dizajnit;
- Mëson rreth përdorimit të dekorimit në kulturat në mbarë botën.

Materiali: letër, lapsa ngjyrosës, shkumësa me ngjyra, markerë, ngjyra uji ose tempera, copa letre me ngjyra të ndryshme, kuti ose enë

Koha dhe hapësira: në klasë, 45 min

Struktura e propozuar e aktivitetit:

Mësimdhënësi shpjegon se ritmi është një nga parimet e artit. Ritmi mund të jetë i rregullt ose i alternuar.

Nxënësit inkurajohen të gjejnë shembuj të ritmit në mjedisin e tyre të afërt, në klasë, në veshje etj.

Nxënësit shikojnë foto dhe video rreth traditës së dekorimit të pjatave në Turqi dhe Kinë (shih më poshtë). **Shtojca 1**



Nxënësit punojnë në grupe prej 4-5 anëtarësh. Secili grup merr një shabllon për pjatë **si në Shtojcën 2** dhe e dekoron atë duke përdorur forma të natyrës të kombinuara me elementë të tjerë të artit (vija, madhësi, tone, tekstura). Kur zbatojnë elementet e artit në dekorimin e një pjate, nxënësit duhet të zbatojnë një nga llojet e ritmit të diskutuar (të rregullt ose të alternuar). Nxënësit kombinojnë disa materiale artistike si: lapsa, shkumësa me ngjyra, stilolapsa, ngjyra tempera, ngjyra uji, etj.

Modelet e përfshira në **Shtojcën 2** mund t'iu tregohen nxënësve si burim frymëzimi.



Veprat e artit të krijuara nga secili grup nxënësish mund të vendosen në tabelën njoftuese të shkollës ose në murin e klasës. Secili grup paraqet veprën artistike dhe shpjegon llojin e ritmit dhe elementet e përdorura të artit.



Rekomandime dhe udhëzime lidhur me aspektet ndërkulturore

Nxënësve mund t'iu paraqiten foto dhe video të motiveve nga dekorimi i porcelanit në Turqi dhe Kinë. Nëpërmjet tyre, ata do të njihen më tepër me kulturat e kombeve të tjera.



Shtojca 1





Shtojca 2

Kupat e famshme kineze ngjyrë të kaltër

Herën tjetër që do të dilni për të ngrënë ushqim kinez, kushtoni vëmendje asaj që është në tryezë.

Ky stil i enëve të tavolinës, i quajtur porcelani linglong, ishte jashtëzakonisht i popullarizuar në Perëndim në vitet '70 dhe '80. Dhe të gjitha vijnë nga ky qytet në Kinë.

Para reformës ekonomike, fabrikat në Kinë ishin të gjitha në pronësi të shtetit. Vitet 1990 shënuan fillimin e privatizimit në shkallë të gjerë. Fabrika e Porcelanit Guangming nuk ishte përjashtim. “Linglong” do të thotë elegant në kinezisht, dhe dizajni i markës tregtare të tyre është ky model i tejdukshëm i kokrrave të orizit.

Ja si bëhet. Balta futet në kallëp, shpohet dhe më pas lustruhet. Më pas vendoset, thahet dhe pritët. Dhe më pas lahet, lyhet, gjë që i jep produktit ngjyrën ikonike të kaltër. Më pas shkon në furra, ku piqet në këto kuti të quajtura “saggar”, dhomë balte që siguron që produkti të nxehet në mënyrë të barabartë në të gjitha pjesët.

Por ndërsa këto kupa dikur ishin kudo, Liu parasheh se së shpejti do të jenë relike e së kaluarës.

VIII

Fusha e kurrikulës: Shoqëria dhe mjedisi

Tema e programit: Evropa pas Revolucionit Francez **(Klasat: IV-IX)**

Qëllimet:

- Vështron ndikimin e Revolucionit Francez në kombet e tjera evropiane;
- Kupton procesin e zgjimit kombëtar të disa kombeve evropiane.

Materiali: letër, lapsa, lapsa për t'u ngjyrosur, lapsa të mprehtë, markerë

Koha dhe hapësira: në klasë, 45 min

Struktura e propozuar e aktivitetit:

Tema e aktivitetit mund të prezantohet në mënyra të ndryshme, për të zbuluar njohuritë e mëparshme të nxënësve për Revolucionin Francez. Ato përfshijnë:

- Teknikën e mbledhjes së mendimeve;
- Loja e asociacioneve me fjalë, për të arritur tek fjala sekrete “Revolucion”. Shihni shembullin dhe udhëzimet në **Shtojcën 1**
- Teknika e Prizmës, duke përdorur “Revolucion” si fjalë fillestare. Shihni udhëzimet në **Shtojcën 2**



Nxënësit shikojnë një video të shkurtër **Shtojca 3** pas së cilës ata (të organizuar në grupe) inkurajohen të ndajnë

- Si organizohej jeta shoqërore në Francë para revolucionit?
- Çka e shkaktoi revolucionin?
- Cilat ishin përfitimet për Francën pas revolucionit?

Nxënësit njihen me dy figura të rëndësishme historike: M. Robespierre dhe N. Bonaparta. Më pas, nxënësit të organizuar në dyshe, paraqesin karakteristikat/veprat/vendimet pozitive dhe negative të dy figurave duke përdorur teknikën T-tabela. **Shih Shtojcën 4**



Napoleoni - Histori e animuar

Në këtë video, nxënësit do të zbulojnë më shumë për Napoleon Bonaparten. **Shih Shtojcën 5**

Nxënësit organizohen në disa grupe për të shënuar bashkërisht në hartë pushtimet e Napoleonit. **Shih Shtojcën 6**

Rekomandime dhe udhëzime lidhur me aspektet ndërkulturore



Nxënësit inkurajohen të gjejnë përkthim të himnit kombëtar francez dhe të zbuloni pse konsiderohet simbol i Revolucionit Francez

Burime shtesë

Hartat mund të përdoren për të treguar ndryshimet që ndodhën në Evropë pas Revolucionit Francez, dhe theksohet zgjimi kombëtar në vendet evropiane



Revolucioni Francez



Revolucioni Francez



Evropa gjatë Revolucionit Francez

Shtojca 1

A1 Baguettet	B1 Hollywoodi	C1 Njeriut	D1 Shekulli i 18-të
A2 Moda	B2 Uashington, D.C.:	C2 Fëmijëve	D2 Avokat
A3 Kulla Eifel	B3 Statuja e Lirise	C3 Luftë	D3 Burrë shteti
A4 Kruasant	B4 Abraham Lincoln	C4 Mbrojtja	D4 Klubi Jakobin
A Franca	B Amerika	C Të drejtat	D Robespierre
Përgjigja përfundimtare - Revolucioni			


Udhëzime për lojën e asociacioneve me fjalë:

Mësimdhënësi do ta përgatisë lojën në tabelë horizontale me fleta ose do ta vizatojë në tabelë. Përgjigjet do të shkruhen në të dhe secila fushë do të mbulohet me një fletë tjetër që do të ketë shkronjat A1, A2...B1, B2...A, B, C...etj., në kopertinë si dhe përgjigjet përfundimtare të fjalëve në të.

Nxënësit do të hapin sipas radhës nga një fushë dhe do të gjejnë përgjigjen. Kështu, për shembull, nëse një student thotë se hap fushën A2 dhe merr përgjigjen mollë...ai/ajo mund ta gjejë përgjigjen në fushën A, d.m.th. kolonën A. Për shembull, ai mund të thotë fruta ose lëng ose diçka tjetër që merr si asociacion për fjalën mollë. Nëse e qëllon saktë, nxënësi vazhdon të hapë një fushë tjetër, nëse nuk e qëllon saktë, nxënësi tjetër e hap një fushë dhe përpiqet ta gjejë e kështu me radhë.

Nxënësit fillimisht përpiqen të gjejnë përgjigjet përfundimtare në fushat/kolonat A, B, C, D dhe më pas, në bazë të tyre, përpiqen të japin përgjigjen përfundimtare të përgjithshme në fund.

Shtojca 2



Udhëzime për teknikën Prizma:

Prizma është teknikë që përfaqëson një kombinim të lidhjeve spontane të fjalëve të një koncepti/fjale të caktuar (zakonisht emri). Rregulli bazë për zbatimin e kësaj teknike është që gjithmonë të shkruani fjalët e para që ju vijnë në mendje.

Prizma realizohet në këtë mënyrë:

1. Një term kyç zgjidhet nga tema në të cilën po punohet dhe jepet si fjalë e parë.
2. Dy fjalët e para që ju vijnë ndërmend, si asociacion i fjalës së parë, shkruhen në rreshtin e parë.
3. Pastaj shkruhen dy asociacione për secilën nga këto dy fjalë.
4. Ky proces zberthimi vazhdon aq herë sa mësimdhënësi dëshiron ose mendon se është e nevojshme.
5. Pastaj fillon procesi i sintezës. Dy nga dy fjalë lidhen me një fjalë.
6. Në fund, nga dy asociacionet e fundit, futet fjala e fundit dhe lidhet me termin kyç.

*Është e rëndësishme të mos përsëriten të njëjtat fjalë.

Shtojca 3

Çka e shkaktoi Revolucionin Francez?

Çfarë të drejtash kanë njerëzit dhe nga vijnë ato? Kush mund të marrë vendime për të tjerët dhe me çfarë autoriteti? Si mund ta organizojmë shoqërinë për të përmbushur nevojat e njerëzve?

Këto pyetje sfiduan një komb të tërë gjatë trazirave të Revolucionit Francez. Nga fundi i shekullit të 18-të, Evropa kishte pësuar ndryshim të thellë intelektual dhe kulturor të njohur si Iluminizmi. Filozofët dhe artistët promovuan arsyen dhe lirinë njerëzore mbi traditën dhe fenë. Rritja e klasës së mesme dhe materialet e shtypura inkurajuan ndërgjegjësimin politik dhe Revolucioni Amerikan e kishte kthyer një ish-koloni angleze në republikë të pavarur.

Megjithatë, Franca, një nga vendet më të mëdha dhe më të pasura në Evropë, ende qeverisej nga një regjim i vjetër i tre klasave të ngurta shoqërore të quajtura Estates. Mbreti i monark Luigji XVI e bazonte autoritetin e tij në të drejtën hyjnore dhe u jepte privilegje të veçanta klasës së parë dhe të dytë, klerit katolik dhe fisnikëve. Klasa e tretë, tregtarët dhe zejtarët e klasës së mesme, si dhe mbi 20 milionë fshatarë, kishin shumë më pak pushtet dhe ishin të vetmit që paguanin taksa, jo vetëm mbretit, por edhe klasave tjera. Në vitet me rendiment të ulët, taksat mund t'i linin fshatarët pothuajse pa asgjë, ndërsa mbreti dhe fisnikët bënin jetë luksoze me pasurinë e tyre të mbledhur.

Derisa Franca u zhyt në borxhe për shkak të mbështetjes së Revolucionit Amerikan dhe luftës së saj të gjatë me Anglinë, nevojitej ndryshim. Mbreti Luigji e emëroi si ministër të financave Jacques Necker, i cili nxiti reformat tatimore dhe fitoi mbështetjen e publikut duke publikuar hapur financat e qeverisë. Mirëpo, këshilltarët e mbretit i kundërshtuan me forcë këto nisma. I dëshpëruar për të gjetur zgjidhje, mbreti e thirri një mbledhje të "Estates-General", Asambleja me përfaqësues nga Tri-Klasat, për herë të parë në 175 vjet.

Megjithëse Klasa e Tretë përfaqësonte 98% të popullsisë franceze, vota e saj ishte e barabartë me secilën nga Klasat tjera. Dhe, çuditërisht, të dyja Klasat e larta ishin në favor të mbajtjes së privilegjeve të tyre. Duke kuptuar se nuk mund të kishin përfaqësim të drejtë, Klasa e Tretë u shkëput, e shpalli vetën Asambleja Kombëtare dhe zotua të hartonte një kushtetutë të re me ose pa klasat e tjera.

Mbreti Luigji urdhëroi që Klasa e Parë dhe të Dytë të takoheshin me Asamblenë Kombëtare, por ai gjithashtu e shkarkoi Neckerin, ministrin e tij të njohur të financave. Si reagim, mijëra parisienë të indinjuar u bashkuan me ushtarë dashamirës për të sulmuar burgun e Bastija (“Bastille”), një simbol i fuqisë mbretërore dhe një depo e madhe armësh. Revolucioni kishte filluar.

Ndërsa rebelimi u përhap në të gjithë vendin, sistemi feudal u shfuqizua. Deklarata e Kuvendit për të Drejtat e Njeriut dhe Qytetarit shpalli një ide radikale për kohën: se të drejtat dhe liritë individuale ishin themelore për natyrën njerëzore dhe qeveria ekzistonte vetëm për t'i mbrojtur ato.

Privilegjet e tyre u zhdukën, shumë fisnikë u larguan jashtë vendit, duke iu lutur sundimtarëve të huaj të pushtonin Francën dhe të rivendosnin rendin. Dhe ndërsa Luigji mbeti si figura e monarkisë kushtetuese, ai kishte frikë për të ardhmen e tij. Në vitin 1791, ai u përpoq të largohej nga vendi, por u kap. Përpijekja për arratisje shkatërroi besimin e njerëzve te mbreti. Familja mbretërore u arrestua dhe mbreti u akuzua për tradhti. Pas një gjyqi, mbretit të nderuar dikur iu pre koka publikisht, duke sinjalizuar kështu fundin e monarkisë njëmijëvjeçare dhe duke finalizuar deklaratën e 21 shtatorit të republikës së parë franceze, e qeverisur nga motoja “liberte, égalité, fraternite” (liri, barazi, vëllazëri). Nëntë muaj më vonë, u ekzekutua edhe mbretëresha Marie Antoinette, një e huaj e tallur prej kohësh si “Madame Deficit” për reputacionin e saj ekstravagant.

Por Revolucioni nuk do të përfundonte këtu. Disa liderë, të pakënaqur me ndryshimin vetëm të qeverisë, u përpoqën të transformonin plotësisht shoqërinë franceze -- fenë e saj, emrat e rrugëve, madje edhe kalendarin e saj. Ndërsa u formuan fraksione të shumta, jakobinët ekstremistë të udhëhequr nga Maximilien Robespierre nisën një fushatë terrori për të shtypur qoftë edhe mospajtimin më të vogël, duke ekzekutuar mbi 20,000 njerëz përpara rënies së vetë Jakobinëve. Ndërkohë, Franca e gjeti veten në luftë me monarkët fqinjë që kërkonin të mbytnin revolucionin përpara se të përhapej. Në mes të kaosit, një gjeneral i quajtur Napoleon Bonaparta mori përgjegjësinë, duke u bërë Perandor pasi pretendonte të mbronte vlerat demokratike të Revolucionit.

Në përgjithësi, Revolucioni nxori tre kushtetuta dhe pesë qeveri brenda dhjetë viteve, të pasuara nga dekada të ndryshimeve midis monarkisë dhe revoltës përpara se të formohej Republika tjetër në vitin 1871. Dhe ndërsa festojmë idealet e Revolucionit Francez, ne ende kemi dilema rreth shumë nga pyetjet themelore të ngritura mbi dy shekuj më parë.

Shtojca 4

Tabela T (grafiku T) është teknikë për krahasimin e dy deklaratave për të njëjtën temë. Duke vepruar kështu, jepen argumente që merren nga mendimet ose diskutimet në formë binare: PO-JO ose PËR-KUNDËR ose POZITIV-NEGATIV.

+	-

Napoleoni - Histori e animuar

Napoleon Bonaparta ishte udhëheqës ushtarak francez, i cili u shqua gjatë Revolucionit Francez dhe udhëhoqi disa nisma të suksesshme gjatë Luftërave Revolucionare Franceze. Ai ishte Perandor Francez nga viti 1804 deri 1814, dhe pastaj përsëri shkurtimisht në vitin 1815.

Napoleoni dominoi çështjet evropiane dhe globale për më shumë se një dekadë, ndërsa udhëhoqte Francën kundër një sërë koalicionesh në Luftërat Napoleonike. Ai fitoi shumicën e këtyre luftërave dhe shumicën dërrmuese të betejave të tij, duke ndërtuar një perandori të madhe që sundoi Evropën Kontinentale përpara se ajo të binte përfundimisht më 1815.

Napoleoni lindi si Napoleon nga Bonaparta në Korsikë, nga një familje relativisht modeste, me origjinë italiane, që ishin fisnikë të rangut të ulët. Kur mbushi nëntë vjeç, u transferua në tokën franceze dhe u regjistrua në shkollë fetare në Autun, më 1779. Më pas ai u transferua me bursë në një akademi ushtarake në Brienne-le-Château. Pas përfundimit të studimeve në Brienne në 1784, Napoleoni u pranua në École Militaire (shkolla ushtarake) në Paris. Ai u stërvit për t'u bërë oficer artilerie. Ai po shërbente në ushtrinë franceze kur shpërtheu Revolucioni Francez në vitin 1789.

Ai u ngrit me shpejtësi në radhët e ushtrisë, duke shfrytëzuar mundësitë e reja që lindën nga Revolucioni dhe duke u bërë Gjeneral në moshën 24 vjeçare. Drejtoria franceze përfundimisht i dha komandën e ushtrisë italiane, pasi ai shtypi një revoltë kundër qeverisë nga kryengritësit rojalistë. Në moshën 26-vjeçare, ai filloi fushatën e tij të parë ushtarake kundër austriakëve dhe monarkëve italianë të rreshtuar me Habsburgët, duke fituar pothuajse secilën betejë. Pushtoi gadishullin italian brenda një viti, duke krijuar republika simotra me përkrahje lokale, e duke u bërë hero lufte në Francë.

Më 1798, ai drejtoi një ekspeditë ushtarake në Egjipt, e cila shërbeu si

trampolinë për pushtetin e tij politik. Ai orkestroi një grusht-shteti në nëntor të vitit 1799 dhe u bë Konsulli i parë i Republikës. Ambicia dhe pëlqimi nga publiku e frymëzuan të shkonte më tej, duke u bërë perandori i parë i francezëve në vitin 1804. Dallimet e pazgjidhshme mes britanikëve nënkuptonin që francezët do përballëshin me një koalicion të tretë kah viti 1805. Napoleoni e bëri copash këtë Koalicion me fitore vendimtare në fushatë, si dhe një triumf historik mbi Perandorinë Ruse dhe Perandorinë Austriake në Betejën e Austerlicit, e cila çoi në shpërbërjen e Perandorisë së Shenjtë Romake.

Më 1806, Koalicioni i katërt mori armët kundër tij, sepse Prusia u shqetësua për rritjen e ndikimit francez në kontinent. Napoleoni mundi shpejt Prusinë në betejat e Jenas dhe Auerstedtit, duke marshuar më pas si Ushtri e Madhe thellë në Evropën Lindore dhe duke asgjësuar rusët në qershorin e vitit 1807, në Betejën e Friedlandit. Franca më pas i detyroi kombet e mundura të koalicionit të katërt të nënshkruanin traktatet e Tilsit në korrik 1807, duke sjellë një paqe të paqëndrueshme në kontinent. Tilsiti simbolizonte damkën e madhe të Perandorisë Franceze.

Më 1809, austriakët dhe britanikët sfiduan përsëri francezët gjatë luftës së Koalicionit të Pestë, por Napoleoni forcoi kontrollin e tij mbi Evropën duke triumfuar në Betejën e Wagramit. Në korrik, Napoleoni pastaj pushtoi Gadishullin Iberik, duke shpresuar që të zgjeronte sistemin kontinental, si dhe ta ngulfaste tregtinë britanike me kontinentin evropian, si dhe e shpalli vëllain e tij Joseph Bonaparte mbret të Spanjës më 1808. Spanjollët dhe portugezët u revoltuan me mbështetjen britanike. Lufta e Gadishullit zgjati gjashtë vjet, ku kishte luftë të gjerë guerile, si dhe përfundoi me fitoren e aleatëve kundër Napoleonit.

Sistemi Kontinental shkaktoi konflikte të vazhdueshme diplomatike midis Francës dhe shteteve klientë të saj, veçanërisht Ruisë. Rusët nuk ishin të gatshëm të bartnin pasojat ekonomike të tregtisë së tkurrur dhe vazhdimisht shkelnin Sistemin Kontinental, duke e catur Napoleonin drejt një lufte tjetër. Francezët nisën pushtimin e madh të Ruisë në verën e vitit 1812. Fushata shkatërroi qytetet ruse, por nuk rezultoi me fitoren vendimtare që donte Napoleoni. Ajo rezultoi në kolapsin e Ushtrisë së Madhe dhe frymëzoi një shtytje të përtërirë kundër Napoleonit nga armiqët e tij. Më 1813, Prusia dhe Austria u bashkuan me forcat ruse në

luftën e Koalicionit të gjashtë kundër Francës. Fushata e gjatë ushtarake kulmoi me një ushtri të madhe aleate që mundi Napoleonin në Betejën e Lajpcigut në tetor të vitit 1813, por fitorja e tij taktikenë Betejën e vogël të Hanaut mundësoi tërheqjen në dheun francez. Aleatët më pas pushtuan Francën dhe pushtuan Parisin në pranverën e vitit 1814, duke e detyruar Napoleonin të abdikonte në prill. Ai u internua në ishullin Elba, në brigjet e Toskanës (Itali). Dinastia e Burbonëve u rikthye në pushtet.

Sidoqoftë, Napoleoni u arratis nga Elba në shkurt të vitit 1815 dhe mori kontrollin e Francës edhe një herë. Aleatët u përgjigjën duke formuar koalicionin e shtatë, i cili e mundi atë në Betejën e Uaterlosë në qershor. Ai u dëbua në ishullin e largët britanik të Shën Helenës në Atlantikun e Jugut, ku vdiq gjashtë vjet më vonë në moshën 51-vjeçare.

Ndikimi i Napoleonit në botën moderne solli reforma liberale në territoret e shumta që ai pushtoi dhe kontrolloi, si Holanda, Zvicra dhe pjesë të mëdha të Italisë dhe Gjermanisë moderne. Ai zbatoi politika themelore liberale në Francë dhe në mbarë Evropën Perëndimore. Kodi i tij Napoleonik ka ndikuar në sistemet juridike të më shumë se 70 kombeve në mbarë botën. Historiani britanik Andrew Roberts thotë: idetë që mbështesin meritokracinë tonë moderne botërore, barazinë para ligjit, të drejtat e pronës, tolerancën fetare, arsimin modern laik, financat e shëndosha, e kështu me radhë, u mbrojtën, konsoliduan, kodifikuan dhe përhapën gjeografikisht nga Napoleoni. Këtyre, ai u dha një administratë lokale racionale dhe efikase dhe fundin e banditizmit rural, inkurajimin e shkencës dhe arteve, heqjen e feudalizmit dhe kodifikimin më të madh të ligjeve që nga rënia e Perandorisë Romake.

Shtojca 6



IX

Fusha e kurrikulës: Artet

Tema e programit: Tempo **(Klasat: VI-IX)**

Qëllimet:

- Të kuptohen llojet bazë të “tempeve” me vesh;
- Të kuptohen konceptet bazë të tempit dhe emërtimet e tyre;
- Të vrojtohen ndryshimet e tempos gjatë interpretimit të ndonjë pjese muzikore;
- Të kombinohen tempe të ndryshme kur luani në instrumente muzikore për fëmijë;
- Të zbulohen sinonimet midis tempit - lëvizjes së trupit - shpejtësisë së lëvizjes.

Materiali: letër, lapsa, lapsa për ngjyrosje, flomasterë, markerë, karta simbolesh

Koha dhe hapësira: në klasë, 45 min

Struktura e propozuar e aktivitetit:

Nxënësit dëgjojnë disa shembuj muzikorë dhe vëzhgojnë dallimet në tempo të një kompozimi muzikor, duke përdorur termat e duhur për “shpejt”, “moderuar” dhe “ngadalë”.

Shënim: mësuesi mund të zgjedhë nga kompozimet vijuese muzikore, varësisht nga nevojat e nxënësve dhe kohës së



Adagio në G - minor



Korsakov - Fluturimi i grerëzës

Nxënësit nxiten të përdorin indikatorët italianë të tempos:

Shpejt – Allegro

Moderuar – Moderato

Ngadalë – Adagio



Saint-Saens - Mjellma



Eine Kleine Nachtmusik



Beethoven - Pathetique

Ushtrimi n. 1 - Gjeni tempin (ritmin): ndërsa dëgjojnë pjesë të ndryshme muzikore të luajtura nga mësimdhënësi, nxënësit e vrojtojnë tempin duke përdorur karta simbolesh me tempin e shkruar të saktë të shkruar mbi to. **Shih Shtojcën 1**

Audio-Kuiz



Nxënësit nxiten të shkruajnë llojet e tempove që dëgjojnë në pjesën muzikore të mëposhtme.

Ushtrimi n. 2 - Sinonime: nxënësit duhet të lidhin lloje të ndryshme tempi me ngjarje të jetës së përditshme, si lëvizja, ecja, vrapimi.

Sugjerim për sinonimet: kafshët. Tre tempet bazë muzikore shkruhen në copë letre, të ndarë në tre kolona. Në secilën kolonë, nxënësit duhet të shkruajnë një emër të kafshës që lëviz me një ritëm të caktuar. Më pas nxënësit lexojnë përgjigjet e tyre dhe diskutojnë shpejtësinë e kafshëve dhe si do të tingëllonte lëvizja e tyre nëse do të luhej.



Nxënësit lexojnë përgjigjet e tyre dhe diskutojnë për shpejtësinë e kafshëve dhe si do të tingëllonte lëvizja e tyre nëse do të luhej. Përveç kësaj, ata dëgjojnë “Karnavalin e Kafshëve” të kompozitorit francez Camille Saint-Saëns.

Exercise n. 3 - Change in tempo: shembujt e muzikës tregojnë se ritmi mund të ndryshojë gradualisht, nga i ngadalshëm në të shpejtë dhe anasjelltas. Shembuj për ndryshimin e tempos:



Accelerando Ritardando



Accelerando Shembull



Ritardando Shembull


Njëri nxënës fillon të lëvizë nëpër klasë, në fillim ngadalë, pastaj duke përshpejtuar gradualisht dhe përfundimisht duke vrapuar. Nxënësit e tjerë duhet të tregojnë një kartë simbolesh që thotë Accelerando (dhe anasjelltas për Ritardando). Veprimi përsëritet disa herë, me lëvizje të nxënësve të ndryshëm.

Pas kësaj, nxënësit vendosen në rreth dhe lëvizin në koordinim me shembullin muzikor që dëgjojnë, duke treguar kështu ndryshimin gradual të ritmit.



Ushtrimi n.4 – Agogjia: ndryshime të vogla të ritmit gjatë performancës me qëllim të prodhimit të efekteve të ndryshme muzikore quhen agogji. Nxënësit dëgjojnë pjesën zanore (audio) dhe vrojtojnë dallimet e ndryshme dhe lirinë në performimin e komponimit muzikor.

Ushtrimi n.5 – Metronomi: metronomi është pajisje që ndihmon në përcaktimin e saktë të llojit të tempos dhe përdoret më së shpeshti gjatë ushtrimit të muzikës.



Nëse është e mundur, përdorni këtë pajisje kur bëni ushtrime me studentët. Zgjidhni një melodi që të gjithë dinë për ta luajtur ose kënduar në instrumentin e fëmijëve dhe interpretojeni me anë të metronomit. Nëse metronomi nuk është i disponueshëm në klasë, në vend të kësaj mund të luhet një video-xhirim i një metronomi ndërsa studentët performojnë.

Video metronomi



Mälzel Holz Metronom

Rekomandime dhe udhëzime ndërkulturore



Tomi & Xherri -
Koncerti i Maces



Franz List - Rapsodia
hungarez



Tomi dhe Xherri
- Nostalgi

Nxënësit shikojnë “Koncertin e maces”, një episod të filmit vizatimor Tomi dhe Xherri, fitues i Oskarit në prill të vitit 1947. Qëllimi është që nxënësit të mësojnë titullin e kompozimit muzikor që është përdorur në filmin e vizatuar, dmth, Rapsodia Hungareze nr. 2 e kompozitorit Franz Liszt, si dhe për të identifikuar tempin, dmth. ndryshimet në tempo gjatë filmit vizatimor.



Accelerando

Në përshpejtim



Ritardando

Në ngadalësim



Allegro

Shpejt



Moderato

Moderuar



Adagio

Ngadalë

Fusha e kurrikulës: Shkenca të natyrës

Tema e programit: Lidhjet kimike dhe lidhjet jonike **(Klasat: VI-IX)**

Qëllimet:

- Të mësohet rreth formimit të joneve me heqjen dhe shtimin e elektroneve;
- Të mësohet për formimin e lidhjeve jonike ndërmjet metaleve dhe jometaleve;
- Të zbulohen elektronet valente;
- Të zbulohet struktura rrjetore të komponimeve jonike dhe vendosjen e mirëfilltë alternuese të joneve pozitive dhe negative.

Materiali: letër, lapsa për ngjyrosje, markera, letër vetëngjitëse me ngjyra të ndryshme, shportë, zarfe, plastelinë, kruese dhëmbësh, ngjitës, shirit ngjitës

Koha dhe hapësira: në klasë, 45 min

Struktura e propozuar e aktivitetit:

Aktiviteti fillon me këto lojëra edukative garuese:

Atomi dhe molekula: nxënësit lëvizin lirshëm nëpër klasë me ritmin e tyre (të shpejtë ose të ngadaltë). Mësimdhënësi/ja jep njërin nga udhëzimet e mëposhtme:

- “Atom”: nxënësit ndalojnë dhe secili prej tyre përfaqëson një atom,
- “Lëvizje”: nxënësit fillojnë të lëvizin përsëri,
- “Molekula 2”, “Molekula 3”, “Molekula 4” ose “Molekula 5”: nxënësit kapin për dore numrin e përmendur të nxënësve tjerë sa më shpejt që është e mundur.
- Ngjyra në ballë: mësimdhënësi/ja ngjit një katror të vogël letre vetëngjitëse në disa ngjyra të ndryshme në ballin e secilit nxënës (ndërsa nxënësit nuk mund ta shohin ngjyrën e vet). Disa katrorë janë të së njëjtës ngjyre. Me shenjën e mësimdhënësit, nxënësit me ngjyra identike duhet të mbajnë dorën e njëri-tjetrit pa folur me njëri-tjetrin.

Loja pasohet me një bisedë të shkurtër dhe udhëzime si dhe prezantohet tema e ditës, përkatësisht lidhjet kimike dhe jonike.


Puna në çifte: Në këtë pjesë të aktivitetit, nxënësit ndahen në çifte dhe secilit anëtar të çiftit i caktohet një element kimik metalik nga grupi 1 dhe jometalik nga grupi 17, si dhe metali nga grupi 2 dhe jometali nga grupi 16.

Shënim: Mësimdhënësi do të zgjedhë elementet që do të përdoren për aktivitetin, në varësi të njohurive të nxënësve dhe lidhjes me programin mësimor.

Vendosni një shportë plot me topa letre me ngjyra të ndryshme në qendër të klasës. Nxënësit duhet të marrin nga koshi aq topa sa ka elektrone valente në elementin e tyre.

Pasi të merren të gjithë topat, çiftet e nxënësve duhet të mendojnë dhe diskutojnë se cilit student t'i japin një top elektroni, pse po e bëjnë atë dhe çfarë ndodh me atomin kur ai humbet ose fiton elektrone.

Nxënësit do të zbulojnë se metalet në grupin 1 do t'u japin një elektron jometaleve në grupin 17, ashtu që të fitojnë strukturë të qëndrueshme elektronesh me mburojë të plotë, si dhe që metalet në grupin 2 do t'u japin dy elektrone jometaleve në grupin 16. Pas humbjes dhe fitimit të elektroneve, nxënësit arrijnë në përfundimin se nuk janë më elektroneutralë, por bëhen jone me ngarkesë pozitive ose negative, ndërsa nxënësit në çift i mbajnë duart njëri-tjetrit për lidhjen jonike të formuar!



Aktivitet mozaiku: nxënësit ndahen në grupe të vogla dhe secili grup merr një zarf që përmban pjesë të mozaikut, përveç njëres pjesë e cila vendoset në zarfin e një grupi tjetër, kështu që mozaiku nuk mund të zgjidhet pa gjetur dhe marrë copëzën e duhur. **Shih Shtojcën 1**

Zarfet përmbajnë elementë për formimin e lidhjeve jonike në NaCl, MgF₂, MgO. Zarfave u mungon një numër ngarkese, elementi ose rrethi elektronesh.

Pas plotësimit të mozaikut, grupet prezantojnë detyrën e tyre, duke përshkruar metodën që kanë përdorur dhe zgjidhjen që kanë gjetur (ose nuk kanë gjetur) për pjesën që mungon.

Aktiviteti i kripës: punë në grupe të vogla. Nxënësit ndahen në tre grupe me detyrën e krijimit të një strukture rrjete me klorur natriumi.

Grupet përdorin materialin vijues:

Grupi i parë - plastelinë dhe kruese dhëmbësh;

Grupi i dytë - letër dhe ngjitës;

Grupi i tretë - shirit ngjitës.



Nxënësit shikojnë një video rreth përgatitjes së kripës **Shtojca 2**

Nxënësit organizohen në grupe dhe hulumtojnë se cilën kripë përdorim në ushqimin tonë të përditshëm. Ata mund të përdorin lidhjet e dhëna në rekomandimet dhe udhëzimet ndërkulturore.

Rekomandime dhe udhëzime ndërkulturore




Nxënësit inkurajohen të mësojnë fakte më interesante për kripën, të lidhura me vende të ndryshme gjeografike. **Shtojca 3**

- Cila kripë përdoret në dietën tonë?
 - Kripa e Himalajeve – Vendi i origjinës: Pakistani
 - Kripa e Tuzlës – Vendi i origjinës: Bosnja dhe Hercegovina
 - Kripa e Detit të Vdekur
- Cilat vende janë vendet e botës që prodhojnë më së shumti kripë?


Shtojca 1




NaCl



MgF₂



MgO



Shtojca 2

Formimi i NaCl-së

I kemi kërkuar Lonnie-t të demonstrojë formimin e lidhjes jonike, në këtë rast, lidhja midis natriumit dhe klorit në klorur natriumi. Kështu që Lonnie mbushi një gotë me element klori. Ky është gazi i klorit, Cl₂. Është gaz i verdhë. Ai do të përdorë edhe metal të ngurtë natriumi. Metali i ngurtë i natriumit është metal i shkëlqyeshëm ngjyrë argjendi që është shumë i butë. Ai në fakt mund ta presë me thikë.

Metalet e natriumit shumë reaktive. Ai reagon ndaj ajrit dhe ujit, kështu që ruhet nën heksan.

Ai do të nxjerrë një copë të vogël dhe, menjëherë, ta fusë nën heksan, ndërsa përgatit pjesën tjetër të eksperimentit. Tani për të nisur reaksionin, ai duhet ta pastrojë natriumin, ta bëjë sipërfaqen shumë të pastër dhe ta ngrohë pak për të ndihmuar në nxitjen e reaksionit.

Ai këtë e bën duke vendosur natriumin në një shpatulle dhe më pas duke e ngrohur atë mbi flakë për të pastruar sipërfaqen dhe për ta ngrohur mjaftueshëm natriumin për të filluar reaksionin kimik. Tani reaksioni midis metalit të natriumit dhe gazit të klorit ndodh, por ne e dimë se energjia e jonizimit të natriumit është më e madhe se energjia e liruar, afiniteti i elektroneve, kur klori pranon elektrone.

Pra, reaksioni vijon, sepse jonet pozitive të formuara në natrium dhe jonet negative të formuara në klor janë bërë bashkë, një ndërveprim kolumbik për të formuar lidhjen jonike.

Formimi i asaj lidhjeje jonike, ngarkesat pozitive e negative të tërhequra bashkë, liron energji dhe kjo është forca shtytëse për këtë reaksion kimik. Dhe mund të shihni se është ekzotermik, energjitë që lirohen, shkëlqimin e kuq të ndezur tipik për emetimet nga natriumi.

Tani reaksioni midis natriumit dhe klorit, natyrisht, formon klorur natriumi. Ne normalisht e dimë kripë të tryezës, ndërsa Lonnie ka përgatitur pak paraprakisht. Ai ka kripë të bardhë gjelle të purifikuar që mund të na tregojë. Atje purifikohet paraprakisht nga Laboratorët Lonnie. Dhe Lonnie më thotë se kripa që ai bën në Laboratorët Lonnie është shumë më superiore se secila kripë që mund të blini në dyqan.

Çfarë duhet të bëjë tash? Lonnie do të demonstrojë - e qartë që nuk ka ngrënë mëngjes sot - se kripa e laboratorëve Lonnie është shumë më superiore se cilado kripë që mund të blini në dyqan.

Faleminderit, Lonnie, për atë demonstrim që kloruri i natriumit është erëz dhe aromatizues i rëndësishëm i ushqimit. Dhe kur e prodhoni vetë, kënaqësia është shumë më e plotë.

Vendet kryesore të prodhimit të kripës në botë

Kripa është një nga mineralet më të zakonshme dhe më të përballueshme në botë dhe luan rol jetik në jetën e përditshme të specieve bimore dhe shtazore. Shumë njerëz përdorin kripën çdo ditë për t'i shtuar shije ushqimit, pasi kripa është një nga shijet më themelore të njeriut. Ky mineral, i quajtur zakonisht kripë guri, halit, kripë e zakonshme ose kripë e tryezës, përbëhet nga klorur natriumi. Me prani në shumë inde bimore dhe shtazore, si dhe në trupa ujqorë, kripa është erëza dhe konzervuesja më e vjetër e njohur e ushqimit, ndërsa të dhënat sugjerojnë se kjo praktikë daton rreth 8000 vjet më parë. Të dhënat nga Shërbimi Gjeologjik Britanik (BGS) dhe Shërbimi Gjeologjik i Shteteve të Bashkuara (USGS) tregojnë se Kina, Shtetet e Bashkuara, India, Gjermania dhe Kanadaja janë disa nga vendet kryesore të prodhimit të kripës në botë.

Prodhimi i kripës sipas vendeve

Kina

Për dekada me radhë, kripa ka siguruar të ardhura të konsiderueshme për Kinën. Fillimisht, dinastitë monopolizuan prodhimin e saj duke i ndaluar banorëve të thjeshtë të prodhonin ose shisnin mineralin. Në vitin 1949, Republika Popullore e Kinës që sapo ishte krijuar vazhdoi këtë trend, me monopolin shtetëror të industrisë, dhe deri në vitin 2003, u formuan institucione shtetërore të pavarura për të menaxhuar dhe rregulluar prodhimin e kripës, të cilat ndihmuan në ruajtjen e monopolit. Korporata Shtetërore e Industrisë së Kripës së Kinës (China Salt) është organi i mandatuar për të mbikëqyrur industrinë dhe ka staf prej rreth 48,476 personash, si dhe më shumë se 7 miliardë dollarë pasuri. Aktualisht, Kina prodhon 68,517,465 tonë kripë në vit. Pavarësisht niveleve të larta të prodhimit, kostoja e kripës mbetet prapë relativisht e lartë, gjendje kjo që i vishet monopolizimit.

Shtetet e Bashkuara

SHBA-ja renditet e dyta në nivel global, duke prodhuar rreth 44,312,914 tonë në vit, që paraqet 14,54% të furnizimit të përgjithshëm të kripës në botë. Është interesante se vetëm shtatë shtete janë përgjegjëse për prodhimin e 95% të totalit shtetëror. SHBA-ja ka mjaft rezerva kripe dhe depozita në kupola nënujore dhe vende të tjera, ndërsa 28 kompani kanë autorizim për të operuar 67 uzinat e kripës në 16 shtete, duke përfshirë shtetet si Kansas, Utah, Luiziana, Ohio, Michigan dhe Nju Jork. Në këto shtete, nxjerrja e kripës bëhet me miniera nëntokësore ose përdorimin e teknologjisë së avullimit diellor ose me vakum.

India

India renditet e treta për prodhimin global të kripës, me rreth 27,006,626 tonë, që nënkupton 8.86% të prodhimit botëror të kripës. Në vitin 1947, vit ky kur vendi fitoi pavarësinë, India importoi kripë nga Mbretëria e Bashkuar, por që nga atëherë, vendi është zhvilluar në lider global në prodhimin e kripës. India e nxjerr kripën kryesisht nga shëllira e detit, shëllira e liqeneve, depozitat e kripës së gurit dhe shëllira nëntokësore. Ka gjithsej 11799 prodhues kripe në Indi, 87.6% e të cilëve janë prodhues në përmasa të vogla me më pak se 10 hektarë hapësirë për prodhimin e kripës. Qeveria qendrore e Indisë monitoron secilin aspekt të industrisë së saj të kripës përmes Zyrës së Komisionerit të Kripës.

E ardhmja e prodhimit global të kripës

Prodhimi botëror i kripës ka pasur lakore në ngritje për periudhën më të gjatë në histori, pasi rritja e shpejtë e popullsisë vazhdon të rrisë kërkesën për produkte. Ky trend ka të ngjarë të vazhdojë tutje, pasi pjesa më e madhe e furnizimit me kripë në botë mbetet pak e shfrytëzuar. Projeksionet janë për një rritje prej 3% të prodhimit dhe më shumë mundësi punësimi në industri në të ardhmen e afërt. Kjo rritje do të ulë më tej çmimet vendore të kripës së tryezës.

Fusha e kurrikulës: Gjuha dhe komunikimi; Shoqëria dhe mjedisi

Tema e programit: Mësimi i gjuhëve të njëri-tjetrit **(Klasat: II, III, IV)**

Qëllimet:

- Mësojmë për gjuhët që fliten në Kosovë
- Mësojmë fjalët themelore në gjuhët e komuniteteve të ndryshme

Materiali: Posterë letre ose tabelë e bardhë, letër, zarfe (ose kuti), altoparantë për muzikë (ose telefon/laptop), fjalor **(Shtojca 1)**

Koha dhe hapësira: në klasë, 40 min

Struktura dhe udhëzimet e aktivitetit:

PJESA 1:

Mësimdhënësi vizaton një trung të madhe me degë në tabelë. Secila degë përfaqëson njëren nga gjuhët më të folura në Kosovë (përkatësisht: shqip, serbisht, turqisht, rome, boshnjakisht).

Mësuesi/ja u drejton nxënësve pyetjet e mëposhtme:

- Cilat komunitete jetojnë në Kosovë?
- Cilat janë gjuhët që fliten në Kosovë?
- Cilat gjuhë flasim në shkollën tonë?
- Cilën gjuhë flisni në familjen/komunitetin tuaj?
- A e dini se cilat komunitete flasin cilën gjuhë?

Mësimdhënësi/ja shkruan në pemë përgjigjet e nxënësve. Përndryshe studentët shkruajnë përgjigjet e tyre në letra të verdha (post-it) dhe i ngjitin në pemë.

Emrat e komuniteteve duhet të vendosen afër gjuhëve të tyre përkatëse.

PJESA 2:

Në shkollat shumëgjuhëshe:

Mësimdhënësi i kërkon nxënësve të thonë dhe të shkruajnë (në letër ose tabelë) fjalët bazë në gjuhën e tyre. E gjithë klasa përsërit secilën fjalë me zë të lartë.

Fjalët bazë duhet të përfshijnë:

- Përhëndetjet (“Tung”, “mirëmëngjesi”, “mirëmbrëma”, “mirupafshim”)
- “Faleminderit”
- “Më fal”
- “Si jeni?”
- (Të tjera - shih Shtojcën 1)

Në rast se nuk fliten të gjitha gjuhët tek nxënësit, ju lutemi referojuni sugjerimit më poshtë.

Në shkollat njëgjuhëshe:

Me anë të fjalorit në Shtojcën 1, mësimdhënësi prenë fjalët bazë në të gjitha gjuhët dhe i vë letrat e vogla në një zarf. Secili nxënës zgjedh një fjalë një herë, e lexon me zë të lartë dhe përipiqet të qëllorë gjuhën e saj.

Të gjitha shkollat:



Nxënësit ecin përreth klasës (pa drejtim apo rend). Mësuesi lëshon muzikë.

Mozart - Marshi turk

Kur muzika ndalon, mësimdhënësi përmend njëren gjuhë dhe secili nxënës duhet të përhëndesë personin pranë tij në atë gjuhë. Sipas mundësisë, të nxiten nxënësit të krijojnë çifte me bashkëmoshatarët nga komunitetet e tjera.

Pas disa sekondash, muzika rifillon dhe loja përsëritet për një fjalë/gjuhë tjetër.

PJESA 3:

Nxënësit ndahen në grupe. Secili grup merr një zarf të mbushur me fjalë në gjuhë të ndryshme (duke përdorur fjalorin në **Shtojcën 1**). Nxënësit duhet të kombinojnë fjalë të gjuhëve të ndryshme që kanë të njëjtin kuptim.

Shënim: fjalori i dhënë në **Shtojcën 1** përfshin gjuhët më të shpeshta të Kosovës. Megjithatë, ka edhe gjuhë të tjera që fliten në Kosovë, përkatësisht: kroate, malazeze, gorane, hebraike, çerkeze. Ato duhet t'u përmenden studentëve dhe mund të përfshihen në Aktivitetet.

Shënim: më shumë fjalë mund të shtohen në fjalor, varësisht nga interesimi i nxënësve dhe niveli i njohurive paraprake.

Konkludime:

Mësuesi shpjegon se mësimi i gjuhëve të komuniteteve të tjera është shumë i rëndësishëm për t'u njohur me njëri-tjetrin. Njohja e më shumë gjuhëve është pasuri për të gjithë ne.

Në Kosovë, komunitete të ndryshme flasin gjuhë të ndryshme. Megjithatë, disa fjalë janë të përbashkëta dhe përdoren nga të gjithë.

Në fund të orës, secili nxënës merr një kopje të fletushkës me shprehjet e shpeshta në gjuhët e komunitetit.

Shtojca 1: Fjalori



ANGLISHT	SHQIP	SERBISHT	BOSHNJAKISHT	TURQISHT	GJUHA ROME
Hello!	Tungjatjeta!	Zdravo!	Zdravo!	Merhaba!	Laqho Dive
Good morning	Mirëmëngjesi	Dobro jutro	Dobro jutro	Günaydın / İyi sabahlar	Laqi Detharin
Good evening	Mirëmbërëma	Dobro veče	Dobro veče	İyi akşamlar	Laqi Rat
Good bye	Mirupafshim	Vidimo se / Doviđenja	Vidimo se / Doviđenja	Görüşmek üzere	Ji po dikhipe
Thank you	Faleminderit	Hvala	Hvala	Teşekkür ederim	Najsipe
Sorry	Më fal	Izvini / Izvinite	Izvini / Izvinite	Affedersiniz	Jeftisar
How are you?	Si je	Kako si? Kako ste?	Kako si? Kako ste?	Nasılsınız?	Sar siyan?

Fusha e kurrikulës: Shoqëria dhe mjedisi; Artet

Tema e programit: Diversiteti kulturor dhe fetar në Kosovë **(Klasat: IV-VII)**

Qëllimet:

- Mësojmë për objektet e ndryshme kulturore dhe fetare në Kosovë
- Kuptojmë dobitë e të jetuarit në shoqëri të larmishme dhe me respekt

Materiali: Fotografi dhe pyetje kuizi **(shih Shtojcën 1 dhe 2)**

Koha dhe hapësira: në klasë, 45 min

Struktura dhe udhëzimet e aktivitetit:

PJESA 1:

Kuiz për objektet kulturore dhe fetare të Kosovës:

Nxënësit ndahen në dy ose më shumë ekipe. Secili ekip duhet të zgjedhë një tingull (ose gjest) të veçantë dhe të zgjedhë një drejtues ekipi.

Mësimdhënësi tregon fotografitë dhe paraqet pyetjet **Shtojca 1.**

Për të pasur të drejtën për t'u përgjigjur i pari, drejtuesi i ekipit duhet të bëjë fillimisht tingullin ose gjestin e veçantë të ekipit të tij/saj. Në rast se përgjigja e dhënë nga ekipi i parë është e gabuar, atëherë ekipi i dytë mund të përgjigjet, e kështu tutje, me radhë. Mësimdhënësi është arbitri.

Lokacionet e sugjeruara (si në Shtojcën 1): Xhamia e vjetër në Gjakovë, manastiri ortodoks në Graçanicë, kalaja e Novobërdës, Ulpiana, monumenti i minatorëve në Mitrovicën e veriut, Kalaja në Prizren, varrezat hebraike në Prishtinë.

PJESA 2:

Nxënësit ndahen në katër grupe (ose më shumë). Secili grup merr një fotografi të objekteve kryesore kulturore dhe fetare të qendrës historike të Prizrenit.

shpjegon se të gjitha grupet fokusohen tek objekte të ndryshme kulturore dhe fetare të qytetit të Prizrenit.

Nxënësit u përgjigjen pyetjeve vijuese (në grupe, me shkrim ose me gojë):

- Cilin(ët) monument(e) shihni në foto?
- Çfarë përfaqëson ky monument/vend?
- A është ky vend veçanërisht i rëndësishëm për një (ose më shumë) komunitete? Cilin(ët)? Pse?
- Cilat janë ngjashmëritë midis fotove të ndryshme? Dhe cilat janë dallimet?
- Kush mund ta vizitojë këtë vend?
- A e vizitojnë turistët këtë vend? Pse?

Lokacionet e sugjeruara Shtojca 2 Xhamia e Sinan Pashës, Katedralja Ortodokse e Shën Gjergjit, Katedralja Katolike e Zojës Ndhimtare, Kalaja.



Prizren

Mësimdhënësi/ja pyet nxënësit: Cilat janë dobitë e një mjedisi shumëkulturor për një qytet si Prizreni? (përgjigjet mund të jenë: më shumë turistë, organizimi i festivaleve të famshme si DokuFest, etj.)

Konkludime:

Mësuesi/ja pyet nxënësit se çfarë mësuan gjatë mësimit. Duke u bazuar në përgjigjet e nxënësve, mësuesi thekson konstatimet vijuese:

Objektet kulturore dhe fetare janë trashëgimi dhe pasuri e përbashkët, pasi janë pjesë e historisë dhe kulturës së komuniteteve të Kosovës.

Për këtë arsye, është e rëndësishme të respektohen të gjitha objektet

Vendet si Prizreni, ku takohen kultura dhe komunitete të ndryshme, mund të kenë shumë përparësi. Ndër të tjera, ato tërheqin turizëm dhe vizitorë nga Kosova dhe jashtë saj.

Shënim: Sipas mundësisë, rekomandohet kombinimi i aktivitetit me një vizitë në objektet kulturore dhe fetare të Prizrenit. Përveç kësaj, rekomandohet që nxënësve t'u jepet detyrë shtëpie një hulumtim i thjeshtë (me përdorim të internetit dhe/ose intervistave) në lidhje me turizmin në Prizren (p.sh. numri i turistëve çdo vit, vendet më të vizituara, reagimet nga turistët).

Shtojca 1: Objektet e trashëgimisë kulturore në Kosovë

1: Në cilin qytet ndodhet ky manastir?

- a. Graçanicë
- b. Prishtinë
- c. Prizren



2: Në foto paraqitet:

- a. Xhamia e vjetër në Prishtinë
- b. Xhamia më moderne në Prishtinë
- c. Xhamia e vjetër në Gjakovë



3: Në cilën epokë është ndërtuar objekti?

- a. Periudha osmane
- b. Periudha antike
- c. Periudha jugosllave



4: Kjo është kalaja e Prizrenit.
Kur është e mundur të vizitohet?

- a. Çdo ditë
- b. Vetëm gjatë fundjavave
- c. Asnjëherë



5: Kjo kala ndodhet në...?

- a. Pejë
- b. Novobërdë
- c. Gjilan



6: Cilëve punëtorë i dedikohet ky monument?

- a. Mjekëve
- b. Zdrukthtarëve
- c. Minatorëve



7: Kjo është ... varrezë

- a. Myslimane
- b. Hebreje
- c. Katolike



Shtojca 2: Prizren



Shënim për mësuesin – Përgjigjet e sakta: 1-a; 2-c; 3-b; 4-a; 5-b; 6-c; 7-b



Fusha e kurrikulës: Shoqëria dhe Mjedisi

Tema e programit: Kuptimi dhe tejkalimi i paragjyqimeve **(Klasat: IV-VI)**

Qëllimet:

- Nxënësi/ja kupton konceptin e “paragjykimit”
- Nxënësi/ja mëson se si shfaqen paragjykimet
- Nxënësi/ja kupton rëndësinë e të njohurit të “tjetrit/ës” përpara se ta gjykojë dikë
- Nxënësi/ja hulumton se cilat komunitete jetojnë në Kosovë

Materiali: Fotografi dhe përshkrime gjegjëse, markerë, lapsa dhe tabela

Koha dhe hapësira: në klasë, 45 min

Struktura dhe udhëzimet e aktivitetit:

PJESA 1:

Mësimdhënësi mund ta prezantojë temën në mënyra të ndryshme:

a) Pyetje:

Mësimdhënësi/ja pyet nxënësit:

- A e dini se cilat komunitete jetojnë në Kosovë?
- Çfarë dini për komunitetet e tjera?
- A keni takuar ndonjëherë dikë nga ndonjë komunitet tjetër? Nëse po, si do ta përshkruanit atë takim? A mund ta ndani përvojën tuaj? (kjo pyetje duhet të përshtatet në varësi të faktit se a kemi të bëjmë me klase me komunitete të përziera apo jo)

b) Lojë:

Nxënësit formojnë një rreth. Secili nxënës mendon për një person të famshëm dhe e thotë emrin e tij/saj me zë të lartë dhe arsyen e përzgjedhjes së këtij personi. Rekomandohet të shmangen politikanët dhe personalitete kontroverze.

Pasi të gjithë nxënësit të kenë thënë emrat e personave të famshëm, formohet rrethi i dytë. Në këtë rreth, nxënësit duhet të përpiqen të kujtojnë personin e zgjedhur nga shoku/shoqja që qëndron në anën e tyre të majtë, t'ia thonë emrin personit dhe të thonë një mbiemër që i përshkruan më së miri cilësitë e personit të famshëm. Nëse nxënësi/ja nuk ka njohuri për personin e famshëm, ai/ajo mund të kërkojë ndihmë nga të tjerët për të gjetur një mbiemër

Pasi të gjithë të kenë folur, mësimitdhënësi/ja u bën nxënësve pyetjet e mëposhtme:

- Pse ka preferenca kaq të ndryshme në lidhje me të famshmit?
- A jeni dakord me mbiemrat që shoku/shoqja juaj i atribuon personaliteti të famshëm që keni zgjedhur? Nëse jo, pse? Si u ndjetë për këtë gjë?
- A e shohim që të gjithë të njëjtin person (ose situatë) në të njëjtën mënyrë?

Shënim: Për klasat me numër të madh nxënësish, rekomandohet ndarja në dy grupe për ta lozur lojën në mënyrë më të shpejtë dhe më dinamike.

PJESA 2:

Nxënësit ndahen në grupe. Secilit grup i jepet një fotografi me persona të panjohur **(Shtojca 1)**. E njëjta fotografi mund t'u jepet më shumë se një grupi. Në bazë të asaj çfarë shohin në foto, nxënësit do të krijojnë identitetin e personit(ave), duke përcaktuar:

- Emrin dhe mbiemrin
- Moshën
- Shtetësinë / Komunitetin
- Profesionin
- Hobit

Nëse ka kohë të mjaftueshme, nxënësit mund ta vizatojnë rrethinën e personit në fjalë në tabelë flipchart duke u bazuar në karakteristikat që ata identifikuan.

Secili grup e paraqet karakterin e tij. Pas secilit prezantim, mësimitdhënësi/ja e zbulon identitetin e vërtetë të personave të paraqitur në foto.

Mësimitdhënësi/ja pyet nxënësit:

- Në çka janë bazuar gjatë përcaktimit të karakteristikave të personit?
- A i kishit të gjitha informacionet e nevojshme për ta hamendësuar historinë dhe identitetin e atij personi?

Në bazë të rezultateve, mësimitdhënësi/ja thekson se ashtu siç ndodhi dhe gjatë ushtrimit, edhe në jetën reale të gjithë pririmi të jemi paragjykes ndaj personave që nuk i njohim. Në shumicën e rasteve kjo bëhet vetëm në bazë të pamjes ose të asaj çfarë kemi dëgjuar për ata person. Kjo quhet "paragjykim". Paragjykimet mund të çojnë në pasoja negative dhe të jenë të dëmshme për personin në fjalë.

Mësimitdhënësi/ja pyet nxënësit:

- Si mund t'i shmangim ose tejkalojmë paragjykimet?
- A mund të jepni ndonjë shembull të një situatë në të cilën keni paragjykuar dikë? (nxënësit ftohen që t'i ndajnë përvojat e tyre)

Përfundimet:

Mësimitdhënësi/ja thekson se, edhe kur mendojmë se të tjerët janë "të ndryshëm" nga ne, nëse i njohim ata më për së afërmi mund të tejkalojmë paragjykimet dhe të zbulojmë aspekte interesante të identitetit dhe historisë së tyre.

Shtojca 1: Fotografi dhe rrëfime



Rrëfim:

Bajram dhe Farije Mehmeti duke i punuar pikturat e tyre në përgatitje të një ekspozite në ambient të hapur që promovon kulturën dhe traditat rome. Vëlla e motër jetojnë dhe veprojnë si piktorë në fshatin Lepi të Komunës së Graçanicës.



Rrëfim:

Dejana Maksiq para salloni të saj të ondulimit në fshatin Osojan të Komunës së Istogut. Dejana është serbe e Kosovës salloni i së cilës është më i pëlqyeri në fshat.



Rrëfim:

Mësimdhënësja shqiptare e Kosovës duke u mësuar nxënësve boshnjakë të Kosovës gjuhën shqipe në një shkollë në Reçan, një vendbanim i madh i boshnjakëve të Kosovës në luginën malore të Zhupës (komuna e Prizrenit). Shkolla është e përzier në aspektin e komuniteteve.



Rrëfim:

Një pronar dyqani serb i Kosovës dhe furnizuesi i tij shqiptar në qytezën Plemetin të Komunës së Obiliqit. Dyqani shet mallra të ndryshme.



Rrëfim:

Pronari i një mulliri tradicional me ujë në fshatin Letnicë të Komunës së Vitisë që prodhon miell gruri dhe misri. Pronari është nga komuniteti kroat i Kosovës.

Fusha e kurrikulës: Shoqëria dhe Mjedisi

Tema e programit: Festat dhe kremtet (festat fetare dhe laike)
(Klasat: IV-VI)

Qëllimet:

- Nxënësi/ja mëson për festat e komuniteteve të Kosovës, kremtet dhe traditat e tyre

Materiali: fotografi dhe përshkrime të festave (**shih Shtojcën 1**), letra me ngjitës me simbole (**shih Shtojcën 2**)

Koha dhe hapësira: në klasë ose ambiente të jashtme, 45 min

Struktura dhe udhëzimet e aktivitetit:

PJESA 1:

Mësimdhënësi/ja prezanton temën duke u drejtuar nxënësve pyetjet e mëposhtme:

- Cilat janë festat kryesore që festohen në Kosovë?
- Cilat nga këto festa janë fetare? Cilat nuk janë?
- Si festohen këto ditë? Ju lutemi ndani përvojat tuaja.

PJESA 2:

Nxënësit ndahen në grupe. Secilit grup i jepen një sërë fotografish që lidhen me ndonjërin nga festat, si dhe një tekst që përshkruan kuptimin e asaj dite dhe traditat që lidhen rëndom me të. **Shtojca 1.**

Nxënësit duhet t'u përgjigjen një sërë pyetjeve (me shkrim):

- Çfarë shihni në foto?
- Kush e feston këtë ditë?
- Pse është e rëndësishme kjo ditë?
- Si festohet zakonisht kjo ditë?

Secili grup paraqet përgjigjet e tij, kurse mësimdhënësi/ja plotëson detajet që mungojnë. Pas prezantimeve të grupeve, mësimdhënësi/ja pyet nxënësit:

- Sot dëgjuam për ditë të rëndësishme që festohen nga komunitete të ndryshme në Kosovë. Çfarë elementesh të përbashkëta kanë këto ditë? (p.sh. të gjitha festat festohen me familjen dhe miqtë)
- Cilat janë dallimet ndërmjet tyre?

Festa të sugjeruara **si në Shtojcën 1:** Bajrami, Krishtlindjet Ortodokse, Pashkët Katolike, Shën Gjergji (Ederlezi), nata e Vitit të Ri

Shënim: Në kuadër të këtij aktiviteti mund të përfshihen edhe festa tjera

PJESA 3:

Nxënësit ndahen në ekipe (të njëjtat grupe si për Pjesën 2). Secilit ekip i caktohet një festë (p.sh. Ekipi A: Bajrami / Ekipi B: Krishtlindjet Ortodokse) dhe pozicionet në rresht në një cep të klasës/fushës.

Në qendër të fushës ose zonës së lojës vendosen copëza letre me simbolet përkatëse të festave **Shih Shtojcën 2.** Mund të përdoren disa kopje të të njëjtit simbol/imazh.

Me sinjalin e mësimdhënësit/es, lojtari i parë i çdo ekipi vrapon drejt qendrës dhe zgjedh një nga simbolet që përfaqëson festën e ekipit të tij/saj (p.sh. lojtarët e ekipit A zgjedhin imazhe që lidhen me Bajramin, lojtarët e ekipit B zgjedhin ato që lidhen me Krishtlindjet etj.). Më pas ai/ajo kthehet tek ekipi, e vendos letrën në dyshe (në një zonë të paracaktuar), dhe lojtari i dytë fillon të vrapojë drejt qendrës. Secili lojtar mund të zgjedh vetëm një letër.

Pasi t'i kenë mbledhur të gjitha letrat, nxënësit dhe mësimdhënësi/ja i shikojnë letrat e mbledhura nga secili ekip dhe diskutojnë nëse përgjigjet janë të sakta. Mësimdhënësi/ja pyet nxënësit nëse mund të identifikojnë ndonjë element të përbashkët (p.sh. Bakllavaja shërbehet si gjatë Bajramit ashtu edhe në Krishtlindjet Ortodokse).

Shënim: loja mund të përshtatet për t'u luajtur në natyrë ose në ambiente të mbyllura, në varësi të hapësirave të disponueshme.

Përfundimet:

Sot mësuam se si festohen festat e ndryshme nga komunitete të ndryshme në Kosovë. Përkundër dallimeve në domethënien dhe traditat, ato kanë shumë elementë të përbashkët (si ushqimi, mysafirët dhe të tjerët). Përveç kremeve që i shtjelluam në kuadër të këtij aktiviteti, në Kosovë festohen edhe ditë të tjera të rëndësishme, siç janë Ditët e Komuniteteve (për shembull, 8 prilli është Dita Ndërkombëtare e Romëve). Është shumë e rëndësishme që të respektohen traditat dhe ditët e veçanta të të gjitha komuniteteve.

Shtojca 1: Festat kryesore



Bajrami / Eid al-Fitr:

Bajrami është festë myslimane, e cila festohet dy herë në vit. “Bajrami i madh” shënon fundin e muajit të Ramazanit, muajit të agjërimit. Kremtimi i Bajramit zakonisht zgjat tre ditë. Besimtarët zgjohen herët në mëngjes, para lindjes së diellit, dhe shkojnë në xhami për lutjet e mëngjesit.

Dita e parë e Bajramit kalohet me familjen e ngushtë, ndërsa dita e dytë dhe e tretë zakonisht u kushtohen vizitave të të afërmeve dhe miqve të tjerë.

Me rastin e Kurban-Bajramit, është e zakonshme të flijohet një qengj (“kurban”), në kujtim të gatishmërisë së Ibrahimit për të flijuar djalin e tij. Mishi i qengjit të flijuar ndahet me familjen dhe komunitetin, veçanërisht personat në nevojë. Për më tepër, ëmbëlsirat si bakllavaja dhe tortet, çaji dhe kafeja u shërbehen gjatë tre ditëve familjarëve dhe mysafirëve.



Krishtlindjet Ortodokse:

Krishtlindja është një festë e rëndësishme për të gjithë të krishterët. Të krishterët ortodoksë festojnë Krishtlindjet më 7 janar. Krishtlindjet përkujtojnë lindjen e Jezusit, figurës qendrore të krishterimit. Kremtimet zakonisht zgjasin tre ditë.

Në vigjilje të Krishtlindjeve, besimtarët shkojnë në kishë. Ditën e Krishtlindjes, familjet vizitojnë njëra-tjetrën, takohen për një drekë të veçantë dhe shkëmbejnë dhurata (sidomos fëmijët).

Shtëpitë zbukurohen me pemën e Krishtlindjeve, drita dhe qirinj.

Edhe pse është festë e krishterë, Krishtlindjet festohen edhe nga shumë jo të krishterë, si në Kosovë ashtu edhe në vende të tjera të botës. Zakonet moderne të festimit të Krishtlindjeve përfshijnë dhënien e dhuratave (Babadimri), muzikën, shkëmbimin e kartolinave, dekorimin e qytetit (si pemët e zbukuruara dhe ndriçimi i veçantë).



Pashkët Katolike:

Pashkët janë festë e rëndësishme për gjithë të krishterët. Pashkët katolike festohen në pranverë (data e saktë ndryshon nga viti në vit). Pashkët shënojnë përfundimin e javës së shenjtë, që përfundon me ringjalljen e Jezusit.

E diela e Pashkëve fillon për shumicën e katolikëve me pjesëmarrjen në Meshën e Pashkëve. Zakonisht, familjet ndjekin organizimet e komunitetit lokal ose kalojnë pjesën e mbetur të ditës me familjen.

Vezët e ngjyrosura janë simbol i pashkëve. Zakonisht u jepen njerëzve të dashur ose përdoren për lojëra. Në disa vende, fëmijët marrin vezë të mëdha dhe të vogla çokollate.



Shën Gjergji:

Dita e Shën Gjergjit festohet nga të gjitha komunitetet në Kosovë më 6 maj. Varësisht nga komuniteti, kjo ditë njihet me emra të ndryshëm dhe ka domethënie të ndryshme: Ederlezi (në gjuhën rome), Đurđevdan (në gjuhën serbe dhe boshnjake), Shëngjergji (në gjuhën shqipe).

Kjo festë shënon fillimin e pranverës dhe fundin e stinës së dimrit.

Traditat e kulturës rome përfshijnë vallëzimin nën tingujt e muzikës popullore tradicionale, ngjyrosjen e vezëve me të gjelbër dhe të kuqe dhe krijimin e elementeve dekorative me lule.



Nata e Vitit të Ri:

Nata e Vitit të Ri festohet ndërkombëtarisht dhe shënon kalimin nga një vit në tjetrin. Ajo festohet natën e 31 dhjetorit, me festa dhe tubime shoqërore që përfshijnë familjen dhe/ose miqtë. Viti i Ri festohet nga të gjitha komunitetet në Kosovë dhe është festë publike.

Në zonat urbane, festimet përfshijnë fishekzjarrë dhe muzikë, ndërsa vallëzimi dhe këndimi vazhdojnë edhe në vende publike deri në mesnatë, kur fillon zyrtarisht Viti i Ri. Në zonat rurale, festimet zakonisht zhvillohen në shtëpi private, të shoqëruara me ushqim, pije dhe muzikë. Pavarësisht se ku e festoni Vitin e Ri, ai përcillet me urimet më të mira për vitin e ri për familjen dhe miqtë.

Shtojca 2: Simbolet e festave

Bajrami




Krishtlindjet Ortodokse



Pashkët Katolike



Shën Gjergji



Nata e Vitit të Ri



Fusha e kurrikulës: Shoqëria dhe Mjedisi

Tema e programit: Stereotipet **(Klasat: V to VIII)**

Qëllimet:

- Nxënësi/ja kupton konceptin e stereotipit
- Nxënësi/ja identifikon lloje të ndryshme të stereotipeve
- Nxënësi/ja kuptoni pasojat e stereotipeve
- Nxënësi/ja mësoni si t'i tejkalojë stereotipet

Materiali: Tabela flipchart, markera me ngjyra dhe lapsa, ngjitës ose shirit

Koha dhe hapësira: në klasë, 45 min

Struktura dhe udhëzimet e aktivitetit:

PJESA 1:

Mësimdhënësi/ja përgatit disa fleta të mëdha letre. Çdo fletë përfaqëson një grup/kategori njerëzish. Nxënësit ndahen në grupe të vogla. Mësimdhënësi/ja i cakton nga një fletë (dhe për rrjedhojë një kategori personash) secilit grup.

Mësimdhënësi/ja përshkruan skenarin e dhënë në vijim, bashkë me udhëzimet vijuese:

Klasa është pjesë e një kompanie projektimi. Kompania ka vendosur të nxjerrë një seri letrash me ngjitës (stikera) me imazhe e simbole që përfaqësojnë grupe të ndryshme të njerëzve.

Nxënësit kanë për detyrë që të:

1. Diskutojnë në grup se cilat porosi duan t'i përcjellin: Cilat janë karakteristikat kryesore të kësaj kategorie personash? Si mund të pasqyrohen ato?
2. Të krijojnë një (ose më shumë) letra me ngjitës që simbolizon kategorinë e personave që u është caktuar grupit të tyre.

Kategoritë/grupet e sugjeruara: burrat/djemtë, gratë/vajzat, gjermanët, italianët, zezakët, profesorët, punëtorë ndërtimi etj.

Pasi të gjitha letrat me ngjitës të jenë përgatitur, mësimdhënësi/ja hap diskutimin me nxënësit duke u bërë pyetjet e mëposhtme:

- Cilat janë porositë që përcjellin letrat me ngjitës?
- Si i keni krijuar ato? Nga vjen informacioni që keni përdorur? A e dini nëse ky informacion është i vërtetë?
- A është dikush që nuk pajtohet me porositë që i përmbajnë letrat me ngjitës? Pse?
- A e dini se çfarë janë stereotipat?

The teacher highlights that we often associate given characteristics to certain groups of people. These are generalizations: indeed, each group is formed by different individuals, who have their own specificities (e.g. not all boys like to play football).

Generalized beliefs about a certain group of persons are called "stereotypes".

PJESA 2:

Nxënësit ndahen në grupe. Në secilin grup, çdo nxënës tregon për përvojat e tij/saj duke iu përgjigjur pyetjeve të mëposhtme:

- A keni pasur ndonjëherë stereotipa për një person (ose grup)?
- A jeni ndjerë ndonjëherë se jeni bërë objekt stereotipizimi nga dikush tjetër?

Alternativë: secili nxënës i vizaton përgjigjet e tij/saj për pyetjet. Të gjitha vizatimet mbledhen së bashku dhe nxënësve u kërkohet të ndajnë përvojën e tyre me klasën (opsionale).

Përfundimet:

Stereotipat për grupe të ndryshme dhe komunitete të tjera janë të përhapur gjerësisht. Është e rëndësishme që t'i njohim ato dhe të shmangim bazimin e gjykimeve dhe sjelljeve tona në to. Vendosja e të tjerëve nëpër "kuti" duke u bazuar në grupin të cilët i përkasin (komuniteti, gjinia, profesioni, etj.) është e gabuar dhe mund të jetë lënduese.

Në Kosovë, stereotipat për komunitetet tjera janë shumë të zakonshme. Për këtë arsye, është shumë e rëndësishme të mbani mend se jo të gjithë personat që i përkasin një komuniteti janë të njëjtë: secili prej nesh ka një histori të veçantë.

Shënim: nëse nxënësit kanë fituar tashmë një nivel të mirë të njohurive rreth temës dhe ka pak rrezik që trajtimi i stereotipave të shkaktojë reagime negative, mësimdhënësi/ja mund t'i eksplorojë më tej stereotipat ekzistuese për komunitetet në Kosovë.

Shembuj të letrave
me ngjitës (stikerëve)

VAJZË



DJALË



Fusha e kurrikulës: Edukata fizike, sportet dhe shëndeti

Tema e programit: Ushqimet dhe gatimet tradicionale **(Klasat: III-V)**

Qëllimet:

- Nxënësi/ja mëson për ushqimet, pijet dhe gatimet tradicionale të komuniteteve të Kosovës
- Nxënësi/ja identifikon elementet e përbashkëta

Materiali: markerë dhe lapsa me ngjyra, letër, karta përkujtuese **(Shtojca 1)**, përshkrimet e gatimeve **(Shtojca 2)**

Koha dhe hapësira: në klasë, 40 - 45 min

Struktura dhe udhëzimet e aktivitetit:

PJESA 1:

Mësimdhënësi/ja pyet nxënësit:

- Cili është gatimi apo ushqimi juaj i preferuar?
- Cilat gatime janë tradicionale në familjen/komunitetin tuaj?
- A keni dëgjuar për ndonjë ushqim tjetër tradicional në Kosovë?

Secili nxënës vizaton gatimin e tij (tradicional) të preferuar. Mësimdhënësi/ja i ngjit të gjitha vizatimet së bashku në mur.

PJESA 2:

Nxënësit ndahen në grupe. Ata vendosen në rreth, të ndarë sipas grupeve. Kartat e kujtesës vendosen në qendër të rrethit, në mënyrë të rastësishme dhe të kthyer përmbys. Çiftet e kartave të kujtesës përbajnë foto të gatimeve tradicionale të komuniteteve të ndryshme (përfshirë ushqimet dhe pijet). **Shih Shtojcën 1**

Grupi i parë e fillon lojën duke i zbuluar dy karta: nëse dy kartat përputhen (d.m.th. Përbajnë të njëjtën fotografi), grupi fiton një pikë dhe ka të drejtë të provojë të gjejë kartat edhe një herë.

Nëse dy kartat e zbuluara janë të ndryshme, atëherë ato duhet të kthehen përmbys përsëri dhe të lihen në të njëjtin pozicion. Tani ka radhën grupi i dytë (e kështu me radhë).

Nxënësit duhet të përpiqen që ta mbajnë mend pozicionin e kartave, në mënyrë që t'i përzgjedhin çiftet që përputhen. Grupi që në fund të lojës ka arritur të mbledhë më së shumti çifte të kartave të kujtesës e fiton lojën.

Në fund të lojës, mësimdhënësi/ja u jep nxënësve një përshkrim të shkurtër të të gjitha gatimeve të shfaqura në karta **shih Shtojcën 2**, dhe ato lexohen me zë të lartë.

Mësimdhënësi/ja pyet nxënësit:



- A keni mësuar diçka të re për ushqimet dhe gatimet tradicionale në Kosovë?
- A ka ngjashmëri midis gatimeve të ndryshme?
- Cilat gatime janë tradicionale për komunitete të ndryshme? (p.sh. byreku)

Shënim: në varësi të madhësisë së klasës, loja mund të lozet në dy/tre grupe (me më shumë kopje të kartave të kujtesës).


Përfundimet:

Ushqimi është një aspekt i rëndësishëm i kulturës. Në Kosovë dhe në rajonin e Ballkanit, çdo komunitet ka gatime të veçanta tradicionale. Megjithatë, shumë prej tyre janë të përbashkëta për më shumë komunitete, ndonëse figurojnë shpeshherë me emra të ndryshëm dhe përgatiten në mënyra paksa të ndryshme dhe/ose duke përdorur përbërës të ndryshëm (p.sh. lloje të ndryshme mishi).

Shtojca 1: Kartat e memories



Shtojca 2: Ushqimet dhe pije tradicionale



Kafeja turke: Kafeja turke është një lloj kafeje që përgatitet në një enë të veçantë të quajtur xhezve, duke përdorur kokrra kafeje të bluara shumë imët pa filtrim. Zakonisht shtohet sheqer. Kjo kafe është e rëndomtë në Kosovë dhe në Ballkan, dhe njihet me emra të ndryshëm dhe specifika të ndryshme në procesin e përgatitjes në varësi të vendndodhjes dhe komunitetit.

Sarma: Sarmat përgatiten duke i mbushur gjethet e lakrës ose rrushit me mish dhe oriz. Sarmat konsiderohen gatim tradicional për komunitete të ndryshme në Kosovë dhe zakonisht përgatitet për raste të veçanta. Emri "sarma" vjen nga gjuha turke dhe do të thotë "mbështjellje".

Flia: Flia përgatitet në tepsi të mëdha të rrumbullakëta, zakonisht në ambient të hapur. Ajo përbëhet nga shtresa të shumta petullash të holla të lyera me mazë. Flia është ushqim tradicional shqiptar i Kosovës.

Byreku: Byreku është ushqim tradicional në Kosovë dhe në rajonin e Ballkanit. Byreku bëhet nga disa shtresa brumi të mbushura me mish, djathë, spinaq ose perime të tjera dhe zakonisht shërbehet me kos ose ajran. Në varësi të vendndodhjes, recetat tradicionale të byrekut mund të ndryshojnë paksa dhe, në disa raste, quhet "pite".

Gullashi: Gullashi është supë ose çorbë me mish, perime dhe erëza. Me prejardhje nga Hungaria, gullashi është vakt i zakonshëm në Evropën Qendrore dhe në Ballkan.

Suxhuku: Suxhuku i thatë, pikant dhe i fermentuar konsumohet në disa kuzhina të Ballkanit, Lindjes së Mesme dhe Azisë Qendrore. Kryesisht përbëhet nga mish viçi ose qengji dhe dhjamë.

Mish skare: Pjekja në skarë është një nga mënyrat më të zakonshme të përgatitjes së mishit në Kosovë dhe në rajonin e Ballkanit. Komunitete dhe grupe fetare të ndryshme hanë lloje të ndryshme mishi (p.sh. muslimanët nuk hanë mish derri).

Bakllavaja: Bakllavaja është një ëmbëlsirë brumi me shtresa, që përgatitet duke vendosur mes shtresave të brumit arra të grira dhe duke e ëmbëlsuar me sherbet ose mjaltë. Është një nga ëmbëlsirat më të njohura në Ballkan dhe Turqi.

Qebapët: Gatesë prej mishi të bluar e pjekur në skarë shumë e zakonshme në Ballkan. Varësisht nga vendi, për përgatitjen e qebapëve përdoren lloje të ndryshme mishi.

Mantitë: Mantitë janë copëza të vogla brumi në formë kubi të mbushura me mish viçi të grirë.

Turshitë: Turshitë përbëhet nga një shumëllojshmëri perimesh të fermentuara dhe zakonisht përdoret si meze ose pjatë anësore. Kjo pjatë është shumë e zakonshme në rajonin e Ballkanit dhe përdoret edhe si teknikë konservimi e perimeve.

Matzo: Matzo (ose Matzah) është një bukë pa maja që është pjesë e kuzhinës hebraike në të gjithë botën. Matzo ka po ashtu ka domethënie fetare për hebrenjtë.

REFERENCAT

Bartulović, M., Kušević. B. (2016). *Što je interkulturalno obrazovanje – Priručnik za nastavnike i druge znatiželjnike*. Zagreb: Centar za mirovne studije

Concept for Intercultural Education (2016). Shkup: Ministria e Arsimit dhe Shkencës

Kurrikula bërthamë për arsimin parafillor dhe fillor të Kosovës (Klasët 0, I, II, III, IV, V) (2016). Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë

Kurrikula bërthamë për arsimin e mesëm të ulët në Kosovë (klasët VI, VII, VIII, IX) (2016). Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë

How to Achieve Intercultural Education (2018). Shkup: QDN Shkup

Ljubljana Guidelines on Integration of Diverse Societies (2012). Hagë: Komisionari i Lartë i OSBE-së për Pakica Kombëtare

Sabliq, M. (2014). *Interkulturalizim u nastavi*. Zagreb: Naklada Ljevak

Steps Towards Interculturalism (2022). Shkup: QDN Shkup

Rekomandimet e Hagës në lidhje me të drejtat arsimore të pakicave kombëtare (1996). Hagë: Komisionari i Lartë i OSBE-së për Pakica Kombëtare

Udhëzimet e UNESCO-s për edukimin ndërkulturor (2006. Paris: UNESCO)

Imazhet, videot dhe burimet e përdorura në këtë doracak nuk janë subjekt i së drejtës së autorit.

Ndërkulturalizmi në arsim

Ministria e Arsimit, Shkencës,
Teknologjisë dhe Inovacionit

Misioni i OSBE-së në Kosovë

Qendra për dialog Nansen Shkup